**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA POGRADEC**
**KESHILLI**

Nr. 5080/13 Prot. Pogradec, më 27.12.2024

**VENDIM**

**NR. 161, DATË 27.12.2024**

**PËR**

**" MIRATIMIN DHE DETAJIMIN E BUXHETIT TË BASHKISË POGRADEC PËR VITIN 2025"**

Në mbështetje të ligjit nr. 139/2015 "Per Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar; Ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" i ndryshuar, Ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008, "Per menaxhimin e sistemit buxhetor te Republikes te Shqiperise", i ndryshuar, Ligjin nr.152/2015 "Per sherbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpetimin" i ndryshuar me ligjin nr 99/2024 dt 12.09.2024; V.K.M nr.1108, date 30.12.2015 "Per transferimin nga Ministria e Bujqesise, zhvillimin rural dhe administrimit te ujrave te Bashkite, te infrastruktures te ujitjes dhe kullimit", V.K.M nr.915, date 11.11.2015 "Per transferimin ne pronesi, nga Keshillat e Qarqeve te Bashkite, te rrjetit te rrugeve rurale dhe te aseteve te luajtshme dhe te paluajtshme te ndermarjeve te mirembajtjes se ketyre rruheve" i ndryshuar me VKM 661 dt 21.09.2016; V.K.M nr.433, date 08.06.2016 "Per transferimin ne pronesi te bashkive te pyjeve, kullotave publike sipas inventarit, dhe aktualisht ne administrim te Ministrise te Mjedisit e te ish komunave/bashkive" i ndryshuar me VKM 398 dt 13.05.2020, Udhezimit te Ministrise se Financave nr.2, date 06.02.2012, "Per procedurat standarte te zbatimit te buxhetit", i ndryshuar me nr 6 dt 16.05.2024; Shkresa nr 14488 dt 29.10.2024 "Dergohet transferta e pakushtezuar e pergjithshme dhe sektoriale per vitin 2025" Këshilli Bashkiak

**VENDOSI:**

1. Te miratoje Buxhetin e Bashkise Pogradec per vitin 2025 sipas pasqyrave bashkengjitur te detajuara si me poshte vijon:

1.1 Planin e te ardhurave per Bashkine Pogradec ne total **1,601,850,270 leke** te detajuar si me poshte:

| | | |
|---|---|---|
| 1.1.1 | Te ardhura tatimore dhe jo tatimore ne shumen | **697,500,270 leke** |
| 1.1.2 | Te ardhura nga transfertat | **904,350,000 leke** |

1.2 Planin e shpenzimeve te Bashkise Pogradec ne total si me poshte:

| | |
|---|---|
| 1.2.1 Bashkia Pogradec | **706,880,270 leke** |
| 1.2.2 Qendra Arsimore | **322,958,000 leke** |
| 1.2.3 NMIPP | 364,066,000 leke |
| 1.2.4 NPR | 75,907,000 leke |
| 1.2.5 Sherbimi Zjarrfikes | 33,100,000 leke |
| 1.2.6 Agjensia e Mbrojtjes se Teritorrit | 98,939,000leke |

2. Te miratoje krijimin e Agjensia se Mbrojtjes se Teritorrit e cila konsiston gjithashtu dhe tek te gjitha detyrimet si me poshte:

1.1 Bilanci i Ndërmarrjes do të jetë pjesë e bilancit të Institucionit përkatës.
1.2 Inventarët do të pasqyrohen tek Bilanci i Institucionit përkatës.
1.3 Kontratat e lidhura nga Bashkia Qender do te transferohen tek Agjensia e re e krijuar.

3. Paketa fiskale e vitit 2024 nuk do te ndryshoje per vitin 2025.

4. Te miratoje numrin e punonjesve per vitin **2025 propozohet të jetë 795 punonjës dhe alokimi** si më poshtë:

| | |
|---|---|
| 1. Bashkia Qëndër, Njësitë Adminstrative dhe MZSH | **248 punonjës** |
| 2. Qëndra Arsimore | **257 punonjës** |
| 3. Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike | **140 punonjës** |
| 4. Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit | **75 punonjës** |
| 5. Agjensia e Mbrojtjes se Teritorrit | **75 punonjes** |

Numri i punonjësve me kontratë shërbimi të përkohshme në Bashkinë **Pogradec** për vitin **2025** është menduar të mbetet i pandryshuar, **20 (njëzet)**, mbi **numrin e përgjithshëm (795 punonjës).**

3. Per zbatimin e ketij vendimi ngarkohen te gjitha Drejtorite e Bashkise Pogradec, Njesite Administrative dhe te gjitha Institucionet dhe Ndermarrjet ne varesi te Bashkise Pogradec.

4. Ky Vendim hyn ne fuqi 10 dite mbas shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola KAMOLLI

1.Miratuar me 18 vota

2.Vota Pro 18

3.Vota Kundër 2

4.Vota Abstenim 3

5.Zbardhur më datë 27.12.2024

BASHKIA POGRADEC

PLANI I TE ARDHURAVE PER VITIN 2025

BASHKIA POGRADEC

| | | Plani 2025 |
|---|---|---|
| A | **TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA** | **697,500,270** |
| A.1 | **TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE** | **301,425,887** |
| A.1.1 | **Taksa vendore mbi biznesin e vogël** | 400,000 |
| A.1.2 | **Taksa mbi pasurinë e paluajtshme** | **94,107,647** |
| 1 | Taksa mbi ndërtesën | **83,339,447** |
| a) | *Taksa mbi ndërtesën familje* | *51,361,550* |
| b) | *Taksa mbi ndërtesën biznes* | *31,977,897* |
| 2 | Taksa mbi tokën bujqësore | **5,515,000** |
| 3 | Taksa mbi truallin | **5,253,200** |
| a) | *Taksa mbi truallin familje* | *1,021,600* |
| b) | *Taksa mbi truallin biznes* | *4,231,600* |
| A.1.3 | **Taksa vendore në shërbimin hotelier** | **7,620,000** |
| A.1.4 | **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja** | **200,000,000** |
| A.1.5 | **Taksa e tabelës** | **6,918,240** |
| a) | *Tabele per qellime identifikimi* | *2,168,740* |
| b) | *Tabele per qellime reklamimi* | *4,749,500* |
| A.2 | **TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA** | **46,700,000** |
| 1 | **Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshr** | 2,500,000 |
| 2 | **Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura** | 24,000,000 |
| 3 | **Taksa e rentës minerare 5%** | 200,000 |
| 4 | **Taksa mbi të ardhurat personale 2%** | 20,000,000 |
| A.3 | **TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE** | **316,872,599** |
| A.3.1 | Tarifa me menaxhimit te mbetjeve | **155,230,606** |
| 1 | *Tarifa e pastrimit për familjet* | *81,739,980* |
| 2 | *Tarifa e pastrimit për institucionet* | *720,000* |
| 3 | *Tarifa e pastrimit për biznesin* | *72,770,626* |
| A.3.3 | Tarifa për ndriçimin publik | **41,518,500** |
| 1 | *Tarifa për ndriçimin publik nga familjet* | *31,932,500* |
| 2 | *Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet* | *23,000* |
| 3 | *Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi* | *9,563,000* |
| A.3.4 | Tarifa për gjelbërimin | **75,428,893** |
| 1 | *Tarifa për gjelbërimin nga familjet* | *37,950,000* |
| 2 | *Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet* | *360,000* |
| 3 | *Tarifa për gjelbërimin nga bizneset* | *34,374,293* |
| 4 | Tarife per mirembajtjen e varezave | **12,744,600** |
| A.3.5 | Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë | **31,950,000** |
| 1 | Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë | 1,000,000 |
| 3 | Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 17,[illegible]00,000 |
| 5 | Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit | 500,000 |

| | | |
|---|---|---|
| 6 | Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara dhe vendparkime publike | |
| 8 | Tarifa për pyejt dhe kullotat | 1,000,000 |
| 9 | Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja MNZ | 400,000 |
| 10 | Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave | 10,000,000 |
| 12 | Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet) | 2,050,000 |
| 13 | Tarifa te tjera 7110599 | |
| A.3.6 | Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj | **11,374,000** |
| 4 | Qendra kulturore e fëmijëve | 380,000 |
| 5 | Pallati i sportit | 350,000 |
| 9 | Çerdhet & Kopshtet | 5,544,000 |
| A.3.7 | Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime | 500,000 |
| A.3.8 | Ndermarrja NMI | 4,600,000 |
| A.3.9 | te tjera tarifa | |
| A.3.10 | Te ardhura nga shitja | |
| | | |
| A.4 | **TË ARDHURAT E TJERA** | **21,127,784** |
| 1 | **Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë** | 17,127,784 |
| 7 | **Kundravajtjet administrative (Gjobat)** | 3,000,000 |
| 11 | **Grante nga ndihma ndërkombëtare** | |
| 14 | **Të tjera(ndikim ne mjedis)** | 1,000,000 |
| B | **TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA** | **697,500,270** |
| | TE ARDHURA NGA BUXHETI QENDROR | |
| | Transferta e pakushtëzuar | **579,951,000** |
| | TRANSFERTA SPECIFIKE | **324,399,000** |
| | Arsimi parashkollor | 210,494,000 |
| | Arsimi parauniversitar | 12,170,000 |
| | Mbrojtja nga zjarri | 33,100,000 |
| | Adiministrimi I pyjeve | 20,102,000 |
| | Rruget rurale | 25,989,000 |
| | Ujitja e kullimi | 12,544,000 |
| | Grand per mbetje urbane | 10,000,000 |
| | TOTAL GRAND | **904,350,000** |
| | TOTALI I TE ARDHURAVE | **1,601,850,270** |

**Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar**
**Irsa KARAPANCA**

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC

**BASHKIA POGRADEC**

**PLANI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2025**

BASHKIA POGRADEC

| Nr | EMERTIMET | Plan 2025 |
|---|---|---|
| 1 | **Paga ,sig. shoq** | |
| | Paga | 183,398,670 |
| | Sigurime shoqerore | 29,913,000 |
| | Honorare | 3,600,000 |
| | **Total 1** | **216,911,670** |
| 2 | **Shpenz.administrative** | |
| | Kancelari | 700,000 |
| | Shtypshkrime | 120,000 |
| | Materiale pastrimi | 400,000 |
| | Karburant | 1,500,000 |
| | Pjese Kembimi | 500,000 |
| | Goma makine, bateri | 500,000 |
| | Shpenzime servisim makinash | 300,000 |
| | Siguracion e taksa per mjete transporti | 200,000 |
| | Sherbim printimi, tonera per printer | 1,200,000 |
| | Sherbim Internet | 700,000 |
| | Blerje letra me vlere | 800,000 |
| | Promocione, reklama TV,kronika ,emisione | 1,000,000 |
| | Blerje materilae per QDS | 120,000 |
| | Siguaricion jete Zjarrfikesa | 600,000 |
| | Pajisje informatike | 500,000 |
| | Materiale elektrike dhe hidraulike | 120,000 |
| | Mirembajtje e faqes web | 120,000 |
| | Blerje fishekzjarre | 1,000,000 |
| | Desinsektim-Desinfektim | 3,500,000 |
| | Sherbime dhe materiale te ndryshme | 1,000,000 |
| | Sherbime per mirembajtje godina bashki | 1,000,000 |
| | **Total 2** | **15,880,000** |
| 3 | **Shpenzime operative** | |
| | Shp per energj elektrike | 6,000,000 |
| | Uje | 1,000,000 |
| | Telefon | 240,000 |
| | Sherbim postar | 600,000 |
| | Komisione per nd.ekonomike ,invalide etj | 3,000,000 |
| | Dieta | 200,000 |
| | Kolaudim mjetesh | 100,000 |
| | **Total 3** | **11,140,000** |
| 4 | **Shpenzime te tjera** | |
| | Shpenzime pergjate vitit | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA POGRADEC

| | | |
|---|---|---|
| | Shperblim këshilltarët e kryepleq | 30,000,000 |
| | Fondi I emergjencave | 15,000,000 |
| | Fond social per familjet dhe grate ne nevoje | 500,000 |
| | Fond per Rinine | 500,000 |
| | Fond social perkomunitet rom dhe egjiptian | 500,000 |
| | Ndihma e stimuj per studentet | 400,000 |
| | Fond per detyrimet e prapambetura | 5,000,000 |
| | **Total 4** | **51,900,000** |
| 5 | **Kontribute ndaj te treteve** | |
| | Shpenzime per Keshillin Bashkiak | 3,000,000 |
| | Kontribut per Qarkun | 1,000,000 |
| | Shpenzime per mbetjet ne KRWM | 35,000,000 |
| | Shp , komisjone vjeljen te ardh. Ujesjellesi | 6,000,000 |
| | Shpenzim per mbeshtetjen e Akademise QV | 560,000 |
| | Shpenzime per Grand Park Drilon | 3,000,000 |
| | hpenzime per Shoqaten e Bashkive | 900,000 |
| | Shp transferte QMP SH.A | 70,000,000 |
| | Shp transferte Pogradec Invest Shpk | |
| | **Total 5** | **119,460,000** |
| 6 | **Sherbimet** | |
| | Pastrimi | 160,000,000 |
| | Shpenzime per regjistrim pasurie | 700,000 |
| | Qera | 550,000 |
| | Miremb prog Kompjuterik Dr Taksave + IT | 900,000 |
| | **Total 6** | **162,150,000** |
| 7 | **Shpenzime per evenimente te ndryshme** | |
| | Materiale promovuese | 800,000 |
| | Kartolinat e fundvitit | 120,000 |
| | Trofe (Krenaria, Mirënjohje e Qytetit) | 120,000 |
| | Blerje lule/kurora | 300,000 |
| | Dita e UNESCO-s | 120,000 |
| | Ngjyrat e Stinës | 120,000 |
| | Trashëgimia Kulturore në fokusin e të rinjve | 120,000 |
| | Java e Rinisë | 120,000 |
| | Evenimente te ndryshme | 1,000,000 |
| | **Total 7** | **2,820,000** |
| | **GJITHSEJ SHPENZIME** | **580,261,670** |
| 8 | **Fondi rezerve** | 1,000,000 |
| 9 | **Fondi kontigjences** | 1,000,000 |
| 10 | **Investime/Projektime** | **124,618,600** |
| | **TOTAL** | **706,880,270** |

**Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar**
**Irsa KARAPANCA**

**KRYETAR**
**ILIR XHAKOLLI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA POGRADEC

**BASHKIA POGRADEC**
**PLANI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2025**
**Agjensia e mbrojtjes se Teritorrit**

| Nr | Emertimi | PLAN 2025 |
|---|---|---|
| 1 | **Paga ,sig. shoq** | |
| | Paga | 61,000,000 |
| | Sigurime shoqerore | 10,187,000 |
| | **TOTAL** | **71,187,000** |
| 2 | **Shpenz.administrative** | |
| | Blerje materiale per Policine Bashkiake | 800,000 |
| | Blerje mates aparat per zhurmat | 200,000 |
| | Blerje Bicikleta per Policine Bashkiake | 200,000 |
| | Uniforma per Policine Bashkiake | 1,000,000 |
| | Kancelari | 300,000 |
| | Karburant | 2,000,000 |
| | Pjese Kembimi | 400,000 |
| | Shtypshkrime | 100,000 |
| | Goma makine, bateri | 400,000 |
| | Qera toke | 950,000 |
| | Shpenzime per trajtimin e qenve | 500,000 |
| | Makine per qente | 800,000 |
| | **TOTAL** | **7,650,000** |
| 3 | **Shpenzime te Sektorit te Administrimit te pyjeve** | |
| | Sherbim dru zjarri per ngrohje. | 8,000,000 |
| | Hartim dhe Mbarshtrim I pyjeve | 8,500,000 |
| | Unifomë pyjesh ( dimërore dhe verore) | 500,000 |
| | (Vertex) Instrument per matje ne pyje | 250,000 |
| | Motorcikleta 125 cc (Cope 4) | 450,000 |
| | Kamion 7.5 ton (vetshkarkues) | 1,700,000 |
| | Pyllezim ne pyje | 702,000 |
| | **TOTAL** | **20,102,000** |
| | | **98,939,000** |

**Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar**
**Irsa KARAPANCA**

**KRYETAR**
**ILIR XHAKOLLI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA POGRADEC

BASHKIA POGRADEC

PLANI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2025

SEKTORI I MBROJTJES NGA ZJARRI

| Nr | EMERTIMET | Plan 2025 |
|---|---|---|
| 1 | **Paga ,sigurime shoqërore** | |
| | Paga | 20,000,000 |
| | Sigurime shoqerore | 4,500,000 |
| | **Total 1** | **27,500,000** |
| 2 | **Shpenzime administrative** | |
| | Kancelari | 50,000 |
| | Shtypshkrime | 30,000 |
| | Dieta | 100,000 |
| | **Total 2** | **180,000** |
| 3 | **Shpenzime operative** | |
| | Energji Elektrike | 100,000 |
| | Matertiale pastrimi | 20,000 |
| | Karburant | 2,000,000 |
| | Vaj Makine | 100,000 |
| | Materiale tjera | 145,000 |
| | Pjese kembimi | 500,000 |
| | Goma Makine | 300,000 |
| | Mirembajtje mjete transporti | 400,000 |
| | Siguracione mjete transporti | 50,000 |
| | Shpenzime tjera transporti | 100,000 |
| | Sherbime te tjera mirembajtje | 100,000 |
| | Dru zjarri per ngrohje | 600,000 |
| | Blerje materiale per Zjarrfikesat | 1,005,000 |
| | **Total 3** | **5,420,000** |
| | | **33,100,000** |

Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar
Irsa KARAPANCA

KRYETAR
[illegible]

BASHKIA POGRADEC
PLANI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2025
BASHKIA POGRADEC

| | EMERTIMI I OBJEKTEVE | Objekti | Mbikeqyrje |
|---|---|---|---|
| 1 | Ura e Zëmçës Kryqezimi Proptisht, Bishnice(likujdim) | 80,000,000 | 1,889,384 |
| 2 | Perforcim/ rehabilitim banesash kolektive 2024(likujdim) | 5,500,000 | 314,223 |
| 3 | Shtesa e Sistemimit te Lumit Bucimas(likujdim) | 10,804,812 | 257,993 |
| 4 | Rikonstruksion dhe shtese objekti per shkollen Kajo Karafili Geshtenjas | 15,000,000 | 1,000,000 |
| 5 | Kolaudime 2024 | 2,000,000 | |
| 6 | Sherbim dru zjarri | 7,852,188 | |
| | SHUMA TOTALE PER INVESTIMET | 121,157,000 | 3,461,600 |

Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar
Irsa KARAPANCA

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

BASHKIA POGRADEC

BASHKIA POGRADEC
NDËRMARRJA PARQEVE DHE REKREACIONIT
P/ BUXHETI PER VITIN 2025

| Nr | Emertimet | P/ PLANI 2025 |
|---|---|---|
| 1 | **Paga,sigurime shoqërore** | |
| | Paga | 50,100,000 |
| | Sigurime shoqerore | 8,367,000 |
| | Shuma :1 | 57,467,000 |
| 2 | **Shpenzime operative** | |
| | Kancelari, shtypshkrime | 120,000 |
| | Shpenzime uji | 900,000 |
| | Shpenzime Energjie | |
| | Udhetim e dieta | |
| | Materiale ngrohje e mirmbajtje zyre | |
| | Sherbime te ndryshme ( kalitje, saldime,riparime) | |
| | Shuma :2 | 1,020,000 |
| 3 | **Sherbime te tjera** | |
| | Taksa+siguracione | 250,000 |
| | Shpenzime tjera transporti ( kolaudimi) | 120,000 |
| | Shlyerje detyrime te prapambetura | |
| | Mirembajtje e lapidareve | |
| | Mirembajtje vepra arti | |
| | Sherbime mirembajtje e magazines prane fidanishtes | |
| | Sherbime per prerjen e druve te kalbura qe perbejne rrezik, ne parkun e Qytetit | 120,000 |
| | Mirembajtej varrezat e deshmoreve | |
| | Mirembajtje e lapidareve dhe vepra arti | 200,000 |
| | Shuma: 3 | 690,000 |
| 4 | **Shpenzime blerje** | |
| | Blerje karburant | 1,200,000 |
| | Blerje pjese kembimi e vajra per makinat | 600,000 |
| | Blerje materiale te ndryshme per mirembajtjen e kendeve te lojrave,stolave dhe koshave | 840,000 |
| | Blerje plehra kimike,organike,ushqyes,pesticide dhe fare bari | 960,000 |
| | Blerje markuç vaditje | |
| | Blerje materiale ndertimi dhe boje | 420,000 |
| | Blerje materiale hidraulike,tubo per sistemin ujites dhe markuç vadites | 480,000 |
| | Blerje rroba pune | 240,000 |
| | Blerje vegla pune | |
| | Blerje materiale per riparimin e makines | |
| | Blerje materiale per riparimin e makinave korrse dhe motorseka | 120,000 |
| | Blerje lule natyrale | 1,200,000 |
| | Blerje fare bari | |
| | Blerje Fidana peme dekorative dhe shkurre dekorative | 1,200,000 |
| | Blerje vazo dekorative | [illegible] |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

| | | |
|---|---|---|
| | Blerje koshash mbejurinash per parkun e qytetit dhe plazhet publike | 200,000 |
| | Blerje lende drusore per riparimin e stolave dhe koshave | |
| | Blerje materiale te ndryshme per impiantin vadites tek ODEONI | |
| | Blerje bova sinjalizuese per ne liqen gjate sezonit turistik | |
| | Blerje tabela sinjalizuese dhe informuese ne plazh per sezonin turistik | |
| | Blerje stolash per parkun e qytetit | 600,000 |
| | Blerje pjese kembimi per mirembajtjen e riparimin e bicikletave te ndermarrjes | 120,000 |
| | Blerje materiale per mirembajtjen e shatrivaneve te qytetit dhe pompave sistemin vadites | 600,000 |
| | Blerje materiale per mirembajtjen e pompave dhe sistemin vadites | |
| | Blerje shkurre dekorative | |
| | Blerje materiale te ndryshme per mirembajtjen e zyres dhe ambienteve te punetoreve | 120,000 |
| | Blerje flamuj kombetare dhe banderola per festat dhe flamuj me stemen e bashkise | 450,000 |
| | Blerje materiale pastrimi per banjat publike | 60,000 |
| | Blerje materiale per riparimin e cadrave | 240,000 |
| | Blerje tabela dhe bova sinjalizuese dhe informuese ne plazh per sezonin turistik | 600,000 |
| | Shuma : 4 | 10,550,000 |
| 5 | INVESTIME | |
| | Blerje beze dhe çadra per plazhet publike me logon e bashkise | 1,200,000 |
| | Blerje materiale për sitemin ujites me pika per borduren tek shetitorja 10 Deshmoret | 960,000 |
| | Blerje materiale padane per uren tek Uckat | 300,000 |
| | Blerje Tenda sherbimi | 1,200,000 |
| | Blerje Kjoska sherbimi | 1,200,000 |
| | Ndertim tualeti per punonjesit e N.P.R | 840,000 |
| | Riparim Taracash | 480,000 |
| | Shuma: 5 | 6,180,000 |
| | TOTALI: | 75,907,000 |

**Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar**
**Irsa KARAPANCA**

**KRYETAR**
**ILIR XHAKOLLI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE BASHKIA POGRADEC

Projekt buxheti i Qendres Arsimore per vitin 2025

| | Emertimet | Plani 2025 |
|---|---|---|
| | | |
| 1 | Paga,sig.shoq | |
| | Paga | 65,148,000 |
| | Sigurime shoqerore e shendetesore | 10,866,000 |
| | Total 1 | 76,014,000 |
| 2 | Shpenzime administrative | |
| | Kancelari+shtypshkrime | 200,000 |
| | Total 2 | 200,000 |
| 3 | Shpenzime operative | |
| | Energji elektrike | 4,500,000 |
| | Uje | 3,500,000 |
| | Total 3 | 8,000,000 |
| 4 | Shpenzime te tjera | 3,600,000 |
| | Qera | 600,000 |
| | Kuota ushqimore(cerdhe+kopesht) | 11,880,000 |
| | Total 4 | 16,080,000 |
| | SHUMA | 100,294,000 |

| | | |
|---|---|---|
| | Arsimi parashkollor 09120 | |
| | Emertimet | Plani 2025 |
| 1 | Paga ,sigurime shoqërore | |
| | Paga | 175,341,502 |
| | Sigurime shoqerore | 35,152,498 |
| | Total 1 | 210,494,000 |
| | | |
| | Arsimi parauniversitar '09230 | |
| | Emertimet | Plani 2025 |
| 1 | Paga ,sigurime shoqërore | |
| | Paga | 10,137,610 |
| | Sigurime shoqerore | 2,032,390 |
| | Total 1 | 12,170,000 |

Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar
Irsa KARAPANCA

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

Bashkia Pogradec

NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

## Sektori Mirembajte Infrastrukture Urbane Godina

Projekt -Buxheti 2025

| | | Ne leke | Ne leke |
|---|---|---|---|
| 1 | **Emertim** | **Plan 2024** | **Plan 2025** |
| | Paga 90 punonjes | 46,200,000 | 50,400,000 |
| | Sig.shoqer | 7,715,400 | 8,416,800 |
| | **Shuma** | **53,915,400** | **58,816,800** |
| 2 | **Ndricim Publik rrugor '05.** | **30,000,000** | **30,000,000** |
| | | | |
| | Kancelari | 720,000 | 700,000 |
| | Shtypshkrime | 30,000 | 30,000 |
| | Sherbim interneti | | 300,000 |
| | Mat.zyre | 200,000 | 200,000 |
| | Sherbim postar | 17,000 | 20,000 |
| 3 | **Shpen.adm** | **1,167,000** | **1,250,000** |
| 4 | **Shpenzime** | | |
| | Karburant | 700,000 | 700,000 |
| | Taksa+siguracione | 280,000 | 330,000 |
| | Pjese kembimi | 1,500,000 | 1,500,000 |
| | Shpenzime te tjera transporti+(Kolaudim | 250,000 | 250,000 |
| | **Shuma** | **2,730,000** | **2,780,000** |
| 5 | **Blerje** | | |
| | Materiale ndertimi | 1,400,000 | 7,000,000 |
| | Materiale pune veshmbathje. | 700,000 | 700,000 |
| | UJE | 500,000 | 300,000 |
| | Shpenzime qera sektori automjeteve | 1,500,000 | 1,500,000 |
| | Shpenzime per realizimin e dekorit / | 100,000 | 1,000,000 |
| | Materiale elektrike | 5,000,000 | 6,000,000 |

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Materiale per sherbimin e varrimit | 1,600,000 | 1,600,000 |
| | Sinjalistika horizontale & Vertikale | 2,000,000 | 4,000,000 |
| | Blerje materiale te ndryshme | 1,000,000 | 1,000,000 |
| | Shpenzime lidhje energjie | 850,000 | 400,000 |
| | Sherbim projekt elektrik | 100,000 | 300,000 |
| | **Shuma** | **14,750,000** | **23,800,000** |
| | Blerje Printer PMF | 200,000 | 200,000 |
| | Mjete-pune. | 500,000 | 600,000 |
| | Vine me Kosh | 3,000,000 | |
| | Paisje per oficinen. | 150,000 | 170,000 |
| | Blerje Fv Piston bllokues trafiku | | 500,000 |
| 6 | **Shuma Investime** | **3,650,000** | **1,470,000** |
| | **Totali '05** | **106,212,400** | **118,116,800** |

Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar
Irsa KARAPANCA

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

REPUBLIKA E SHQIPERISE

Bashkia Pogradec

NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

## Sektori Mirembajte Infrastrukture Urbane Godina

Projekt -Buxheti 2025

| | | Ne leke |
|---|---|---|
| 1 | **Emertim** | **Plan 2025** |
| | Paga 90 punonjes | 50,400,000 |
| | Sig.shoqer | 8,416,800 |
| | **Shuma** | **58,816,800** |
| 2 | **Ndricim Publik rrugor '05.** | **30,000,000** |
| | | |
| | Kancelari | 700,000 |
| | Shtypshkrime | 30,000 |
| | Sherbim Interneti | 300,000 |
| | Mat.zyre | 200,000 |
| | Sherbim postar | 20,000 |
| 3 | **Shpen.adm** | **1,250,000** |
| 4 | **Shpenzime** | |
| | Karburant | 700,000 |
| | Taksa+siguracione | 330,000 |
| | Pjese kembimi | 1,500,000 |
| | Shpenzime te tjera transporti+(Kolaudim | 250,000 |
| | **Shuma** | **2,780,000** |
| 5 | **Blerje** | |
| | Materiale ndertimi | 7,000,000 |
| | Materiale pune veshmbathje. | 700,000 |
| | UJE | 300,000 |
| | Shpenzime qera sektori automjeteve | 1,500,000 |
| | Shpenzime per realizimin e dekorit / | 1,000,000 |
| | Materiale elektrike | 6,000,000 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

| | | |
|---|---|---|
| | Materiale per sherbimin e varrimit | 1,600,000 |
| | Sinjalistika horizontale & Vertikale | 4,000,000 |
| | Blerje materiale te ndryshme | 1,000,000 |
| | Shpenzime lidhje energjie | 400,000 |
| | Sherbim projekt elektrik | 300,000 |
| | **Shuma** | **23,800,000** |
| | Blerje Printer PMF | 200,000 |
| | Mjete-pune. | 600,000 |
| | Vinc me Kosh | |
| | Paisje per oficinen. | 170,000 |
| | Blerje Fv Piston bllokues trafiku | 500,000 |
| 6 | **Shuma Investime** | **1,470,000** |
| | Totali '05 | 118,116,800 |

Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar
Irsa KARAPANCA

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

REPUBLIKA E SHQIPERISE - ... POGRADEC

Bashkia Pogradec

NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

**Sektori I rrugeve Rurale**

**Projekt - Buxheti 2025**

| | | Ne Leke |
|---|---|---|
| | Emertim | Plan 2025 |
| 1 | Paga administrata 50 punonjes | 35,600,000 |
| | Sig.shoqer | 5,945,200 |
| | **Shuma 01** | **41,545,200** |
| 2 | Karburant | 10,000,000 |
| | Vajra filtra | 1,500,000 |
| | Siguracione Mjetesh | 590,000 |
| | Blerije material ndertimi | 13,000,000 |
| | Taksa+siguracione | 260,000 |
| | Shpenzime te tjera transporti+kolaudimi | 90,000 |
| | **Shuma 01** | **25,440,000** |
| | Blerje kripe dhe granil | 300,000 |
| | Blerje materiale te ndryshme | 1,000,000 |
| | Goma | 1,500,000 |
| | Pjese nderimi | 1,500,000 |
| | **Shuma 05** | **4,300,000** |
| 3 | **Makineri/ Investime** | |
| | Asfaltimi I rrjetit rrugor ne njesite adm P | 105,000,000 |
| | Minieskavator | 1,800,000 |
| | **Shuma** | **106,800,000** |
| | TOTALI '01+'05 | 178,085,200 |

Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar
Irsa KARAPANCA

KRYETAR
IR XHAKOLLI

**NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE**

**Sektori Arsimit**

**Projekt -Buxheti 2025**

| | | Ne Leke |
|---|---|---|
| | **Emertim** | **Plan 2025** |
| 1 | Blerje karburant per ngrohje. | 19,000,000 |
| | Mirembajtje Institucioneve shkollore | 20,000,000 |
| | | **39,000,000** |
| | Material dezifektimi | |
| | Sherbim dezifektimi | 5,700,000 |
| | Materiale Pastrimi | 2,000,000 |
| | Blerje Fikse zjarri | 950,000 |
| | Blerje Kamera shkolla | 400,000 |
| | Mirmbajtje sistem kamerave | 70,000 |
| | Materiale hidraulike | 900,000 |
| | Materiale elektrike | 900,000 |
| | Materiale hidrosanitare.pllaka | 600,000 |
| | Xhama | 300,000 |
| | Materiale per kaldajat | 350,000 |
| | Materiale per mirembajtjen e dyerve | 350,000 |
| | Blerje Materiale te ndryshme | 1,000,000 |
| | **Shuma** | **13,520,000** |
| 2 | Ndertim mure rrethuese shkollat | 1,000,000 |
| | Blerje soba per ngrohje | 1,800,000 |
| | **Investime** | **2,800,000** |
| | Totali 05 | **55,320,000** |

**Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimit Financiar**
**Irsa KARAPANCA**

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

BASHKIA POGRADEC

NDËRMARRJA E MIRËMBAJTJES SË INFRASTRUKTURAVE DHE PUNËVE PUBLIKE

SEKTORI I UJITJES DHE KULLIMIT

**PROJEKT BUXHETI PER VITIN 2025** Ne leke.

| | Emertim | VITI 2025 |
|---|---|---|
| 1 | Paga administrata 8 punonjes. | 5,615,200 |
| | Sig.shoqer | 937,738 |
| | **Shuma** | **6,552,938** |
| 2 | Kancelari | 30,000 |
| | Shtypshkrime | 18,000 |
| | Mat.zyre | 15,000 |
| | Udhetime, dieta | 28,000 |
| | **Shpen.adm** | **91,000** |
| 3 | Karburant | 3,200,000 |
| | Vaj makine | 400,000 |
| | Pjesë këmbimi | 1,000,000 |
| | **Shpenz.op** | **4,600,000** |
| 4 | Mirembatje Kanale Ujitese-kulluese. | - |
| | Blerje Tubo te brinjezuar | 400,000 |
| | Furnizim Vendosje tubo betoni | 400,000 |
| | Fond rezerve | 500,062 |
| | **Shuma Mirembajtje Inf.Ujitëse** | **1,300,062** |
| | TOTALI | 12,544,000 |

Drejtoria e Ekonomise dhe Menaxhimt Financiar
Irsa KARAPANCA

KRYETAR
ILIR XHAKOLLI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**BASHKIA POGRADEC**
**KESHILLI**

Nr. ______Prot. Pogradec, më ____.___.2024

**RELACION**

**E nderuar Kryetare e Keshillit,**

**Te nderuar Keshilltare,**

**Po ju paraqesim :**

Buxhetin e Bashkise Pogradec per vitin 2025, me renditjen e meposhtme:

**I. Profili i Bashkisë Pogradec**
**II. Analiza Ekonomiko-Financiare e Bashkise Pogradec per periudhen Janar-Nentor 2024**

- ✓ Të ardhura nga taksat dhe tarifat vendore
- ✓ Të ardhurat nga Institucionet e Varësisë
- ✓ Te ardhura te tjera
- ✓ Transferta e pakushtezuar (Granti)
- ✓ Plani per vitin 2025

**III. Analiza e shpenzimeve per vitin aktual dhe plani I shpenzimeve per vitin 2025**

- ✓ Shpenzimet e Bashkise Pogradec

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

- ✓ Shpenzimet nga Ndërmarrjet e Varësise
- ✓ Shpenzimet nga Institucione te transferuara
- ✓ Investimet Total

Qëllimet e Bashkise Pogradec janë:

- ✓ të sigurojë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, nëpërmjet përdorimit racional të tokës dhe të burimeve natyrore;
- ✓ të vlerësojë potencialin aktual e perspektiv për zhvillim të territorit në bazë të balancimit të burimeve natyrore, të nevojave ekonomike e njerëzore dhe interesave publike e private;
- ✓ të nxisë veprimet e duhura për mbrojtjen, restaurimin dhe rritjen e cilësisë së trashëgimisë natyrore e kulturore dhe për ruajtjen e shumëllojshmërisë biologjike dhe të peizazhit;
- ✓ të mundësojë të drejtën e përdorimit e të zhvillimit të pronës, në përputhje me interesat e shoqërisë;
- ✓ të krijojë kushte të përshtatshme, të drejta dhe shanse të barabarta për banim, veprimtari ekonomike e sociale për të gjitha kategoritë sociale, lidhshmëri ekonomike e sociale, si dhe gëzim të të drejtave të pronësisë.

Përgjatë vitit 2024 Bashkia Pogradec ashtu si çdo Bashki në Republikën e Shqipërisë ka pësuar ndryshime të shumta në fondet e miratuara në fillim të vitit. Pergjatë vitit kemi patur ndryshime tek zëri i Investimeve dhe më së shumti ka patur një ndryshim rrënjësor të nivelit të pagave të punonjësve.

Gjithashtu Bashkia Pogradec vazhdon të ketë problemin e detyrimeve të parapambetura. Edhe pse pushteti vendor na ka ndihmuar me fonde për shlyerjen e detyrimeve, përfshihemi tek Bashkitë me problem financiare.

Në vitin 2024 pavarësisht problemeve të shumta, Bashkia ka realizuar investime të cilat kanë patur një ndikim pozititv në komunitet. Përmendim këtu Asfaltimin e rrugëve në Bashkinë Pogradec dhe në njësitë Administrative e cila ka përfunduar këtë vit dhe gjithashtu Asfaltimin e rrugëve në Mokër e cila filloi punën në vititn 2024 dhe do të vazhdojë dhe në vitin 2025. Këto kanë qënë dy investime të cilat do të kenë një shtrirje kohore likujdimi 3 vjeçar.

**ANALIZA EKONOMIKO-FINANCIARE E BASHKISE POGRADEC**

Drejtoria e Taksave dhe TarifaveVendore,në zbatim të legjislacionit tatimor në fuqi, më poshtë ju njeh me parashikimin e të ardhurave për vitin 2025:

Të ardhurat nga burimet e veta vendore, përfshijnë të ardhurat nga taksat vendore, të ardhurat nga tarifat vendore dhe të ardhurat nga taksat e ndara.

Planifikimi i të ardhurave nga taksat dhe tarifat në Bashkinë Pogradec, është mbështetur:

Në nivelet e aplikueshme të taksave dhe tarifave vendore të miratuara si në legjislacionin tatimor në fuqi, ashtu dhe në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr.133, datë 11.12.2023 për "Miratimin e taksave dhe tarifave vendore në Bashkinë Pogradec", i ndryshuar,të cilat përcaktojnë llojet e taksave, bazën e taksueshme, kategorizimet dhe nënkategorizimet, këstet e pagimit, kohën e kryerjes së tyre, efektet e lehtësive, strukturat përgjegjëse për vjeljen e detyrimeve dhe agjentët tatimorë, rregullat për mënyrën e ushtrimit të të drejtave dhe të detyrave nga organet e qeverisjes vendore, për vendosjen e taksave vendore, mbledhjen dhe administrimin e tyre.

Në mënyrë të hollësishme, përveç strukturimit, detajojnë çdo lloj takse të administruar nga organet vendore të administrimit, përcaktojnë qartë edhe administrimin e tyre duke filluar me mënyrën e llogaritjes, personat përgjegjës të pagimit të taksës dhe ato të mbledhjes së saj.
Në realizimet faktike të të ardhurave për periudhën paraardhëse dhe realizimin 11 mujor të vitit 2024.
Nëpër llogaritjet e kapaciteteve reale të taksave dhe tarifave nëpërmjet zgjerimit të bazës së taksapaguesve dhe saktësimit të të dhënave për të cilat janë ndërtuar bazat e të dhënave gjithnjë e më të sakta të taksapaguesve, sipas kategorive, pronarë pasurish, biznes dhe familje, dhe nga viti në vit janë konsoliduar dhe siguruar të dhëna gjithnjë e më të sakta për bazën e taksueshme dhe nivelin e aplikueshëm të taksave dhe tarifave sipas llojeve.
Në parashikimin e mbledhjes së detyrimeve debitore të 18 muajve të fundit , referuar legjislacionit në fuqi duke zbatuar me përpikmëri të gjitha hapat, proçedurat dhe afatet e parashikuara si dhe duke bashkëpunuar ngushtë me aktorët e tjerë për vijimësinë dhe efektivitetin e këtyre masave.
Në parashikimin e të ardhurave që mblidhen nga agjentët tatimorë duke kërkuar, rritur dhe forcuar më tepër kontrollin mbi ta por dhe mënyrën e rakordimit për taksat apo tarifat që këta të fundit mbledhin për llogari të Bashkisë Pogradec.
Në parashikimin e të ardhurave që mblidhen nga drejtoritë e Bashkisë.
Në ecurinë e realizimit të të ardhurave për çdo taksë dhe tarifë si dhe duke analizuar faktorët që kanë ndikuar në rritjen ose pakësimin e arkëtimeve.
Në forcimin e kapaciteteve administruese.
Në lehtësimin e proçedurave dhe përmirësimin e klimës së marrëdhënieve me taksapaguesit.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Drejtoritë e Bashkisë, Institucionet dhe Agjentët Tatimorë janë strukturat kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave nga burimet e veta vendore të Bashkisë Pogradec.

Në mënyrë të detajuar po paraqesim planifikimin për vitin 2025, në lidhje me të ardhurat nga burimet e veta vendore.

Bashkia Pogradec,përbëhet nga qyteti dhe 7 Njësi Administrative: Buçimas, Çërravë, Dardhas, Trebinjë, Proptisht, Udënisht dhe Velçan.

Popullsia e bashkisë numëron rreth 91,951banorë sipas të dhënave të Zyrës së Gjendjes Civile dhe 31,909 Familje.
Numri i popullsisë në Qytet: 39,515 dhe Numri i Familjeve: 14,167.
Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Buçimas : 9,478 dhe numri i Familjeve: 6,554.
Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Çërravë: 39,515 dhe numri i Familjeve: 3,214.
Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Dardhas: 3,407 dhe numri i Familjeve: 1,198.
Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Udënisht: 7,756 dhe numri i Familjeve: 2,722.
Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Proptisht: 5,804 dhe numri i Familjeve: 2,017.
Numri i popullsisë në Njësinë AdministrativeTrebinjë: 2,911 dhe numri i Familjeve: 1,007.
Numri i popullsisë në Njësinë Administrative Velçan: 2,891 dhe numri i Familjeve: 1,030.

| | | **Plani 2025** |
|---|---|---|
| **A** | **TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA** | **697,500,270** |
| **A.1** | **TË ARDHURA NGA TAKSAT LOKALE** | **301,425,887** |
| **A.1.1** | **Taksa vendore mbi biznesin e vogël** | 400,000 |
| **A.1.2** | **Taksa mbi pasurinë e paluajtshme** | **94,107,647** |
| **1** | Taksa mbi ndërtesën | **83,339,447** |
| **a)** | *Taksa mbi ndërtesën familje* | *51,361,550* |
| **b)** | *Taksa mbi ndërtesën biznes* | *31,977,897* |
| **2** | Taksa mbi tokën bujqësore | **5,515,000** |
| **3** | Taksa mbi truallin | **5,253,200** |
| **a)** | *Taksa mbi truallin familje* | *1,021,600* |
| **b)** | *Taksa mbi truallin biznes* | *4,231,600* |
| **A.1.3** | **Taksa vendore në shërbimin hotelier** | **7,620,000** |
| **A.1.4** | **Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja** | **200,000,000** |
| **A.1.5** | **Taksa e tabelës** | **6,918,240** |
| **a)** | *Tabele per qellime identifikimi* | *2,168,740* |
| **b)** | *Tabele per qellime reklamimi* | *4,749,500* |
| **A.2** | **TË ARDHURA NGA TAKSAT E NDARA** | **46,700,000** |
| **1** | **Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë / pasuritë e paluajtshme** | 2,500,000 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA POGRADEC

| | | |
|---|---|---|
| **2** | **Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura** | 24,000,000 |
| **3** | **Taksa e rentës minerare 5%** | 200,000 |
| **4** | **Taksa mbi të ardhurat personale 2%** | 20,000,000 |
| **A.3** | **TË ARDHURA NGA TARIFA VENDORE** | **316,872,599** |
| **A.3.1** | Tarifa me menaxhimit te mbetjeve | **155,230,606** |
| 1 | *Tarifa e pastrimit për familjet* | *81,739,980* |
| 2 | *Tarifa e pastrimit për institucionet* | *720,000* |
| 3 | *Tarifa e pastrimit për biznesin* | *72,770,626* |
| **A.3.3** | Tarifa për ndriçimin publik | **41,518,500** |
| 1 | *Tarifa për ndriçimin publik nga familjet* | *31,932,500* |
| 2 | *Tarifa për ndriçimin publik nga institucionet* | *23,000* |
| 3 | *Tarifa për ndriçimin publik nga biznesi* | *9,563,000* |
| **A.3.4** | Tarifa për gjelbërimin | **75,428,893** |
| 1 | *Tarifa për gjelbërimin nga familjet* | *37,950,000* |
| 2 | *Tarifa për gjelbërimin nga Institucionet* | *360,000* |
| 3 | *Tarifa për gjelbërimin nga bizneset* | *34,374,293* |
| 4 | Tarife per mirembajtjen e varezave | **12,744,600** |
| **A.3.5** | Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë | **31,950,000** |
| 1 | Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë | 1,000,000 |
| 3 | Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit | 17,000,000 |
| 5 | Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit | 500,000 |
| 6 | Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara dhe vendparkime publike | |
| 8 | Tarifa për pyejt dhe kullotat | 1,000,000 |
| 9 | Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrëfiksja MNZ | 400,000 |
| 10 | Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapsirës publike dhe fasadave | 10,000,000 |
| 12 | Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet) | 2,050,000 |
| 13 | Tarifa te tjera 7110599 | |
| **A.3.6** | Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës, sportit etj | **11,374,000** |
| 4 | Qendra kulturore e fëmijëve | 380,000 |
| 5 | Pallati i sportit | 350,000 |
| 9 | Çerdhet & Kopshtet | 5,544,000 |
| **A.3.7** | Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime | 500,000 |
| **A.3.8** | Ndermarrja NMI | 4,600,000 |
| **A.3.9** | te tjera tarifa | |
| **A.3.10** | Te ardhura nga shitja | |
| | | |
| **A.4** | **TË ARDHURAT E TJERA** | **21,127,784** |
| **1** | **Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë** | 17,127,784 |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

| | | |
|---|---|---|
| 7 | Kundravajtjet administrative (Gjobat) | 3,000,000 |
| 11 | Grante nga ndihma ndërkombëtare | |
| 14 | Të tjera(ndikim ne mjedis) | 1,000,000 |
| B | **TË ARDHURA NGA BURIMET E VETA** | **697,500,270** |

**Në Bashkinë Pogradec për vitin 2025, parashikohen të arkëtohen 697,500,270 lekë, nga të ardhurat nga burimet e veta.**

Taksat vendore zënë 50 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të mblidhen për vitin 2025.
Tarifat vendore zenë 47 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen për vitin 2025.
Tarifa të tjera (qira, gjoba, ndikimi në mjedis) zenë 3 % të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen për vitin 2025.

Drejtoria e Taksave dhe Tarifave Vendore planifikohet të mbledhë 61 % të parashikimit të planit.
Drejtoria e Planifikimit, Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit planifikon të mbledhë 31% të parashikimit.
Nga taksat e ndara planifikohet të arkëtohen 6 % të të ardhurave të parashikuara për t'u arkëtuar në vitin 2025.
Nga tarifat e tjera planifikohet të arkëtohen 2 % të të ardhurave të parashikuara për t'u arkëtuar në vitin 2025.

***<u>Nga të ardhurat e taksave vendore parashikohet të arkëtohen 301,425,887 lekë dhe konkretisht nga:</u>***
***Taksa vendore mbi biznesin e vogël 400,000 lekë.***

***Taksa mbi pasurinë e paluajtshme parashikohet të arkëtohen 94,107,647 lekë nga:***
*Taksa mbi ndërtesën 83,339,447 lekë nga të cilat:*

- *51,361,550* lekë nga taksa mbi ndërtesën për familje.
- *31, 977,897* lekë nga taksa mbi ndërtesën biznes.

***Taksa mbi tokën bujqësore pritet të arketohen 5,515,000 lekë.***

***Taksa mbi truallin pritet të arkëtohen 5,253,200 lekë:***

- Taksa mbi truallin për familje *1,021,600 lekë* .
- Taksa për truallin biznes,*4,231,600* lekë.

***Taksa vendore e shërbimit hotelier pritet të arkëtohet vlera 7,620,000 lekë.***

***Taksa e ndikimit në infrastukturë nga ndërtimet e reja parashikohet 200,000,000 lekë.***

***Taksa e tabelës planifikohet 6,918,240 lekë:***

- *2,168,740 lekë* Taksa e tabelës për qëllime identifikimi.
- *4,749,500 lekë* Taksa e tabelës për qëllime reklamimi.

***Nga të ardhurat e tarifave vendore parashikohet të arkëtohen 316,872,599 lekë dhe konkretisht nga:***

***Tarifa e Pastrimit parashikohet të arkëtohen 155,230,606 lekë:***

- *81,739,980 lekë nga Tarifa e pastrimit për familjet.*
- *720,000 lekë nga Tarifa e pastrimit për institucionet.*
- *72,770,626 lekë nga Tarifa e pastrimit për biznesin*

***Tarifa për ndriçim publik parashikohet të arkëtohen 41,518,500 lekë.***

- *Tarifa për ndriçim publik nga familjet 31,932,500 lekë*
- *Tarifa për ndriçim publik nga institucionet 23,000 lekë*
- *Tarifa për ndriçim publik ngabizneset 9,563,000 lekë*

***Tarifa për gjelbërimin*** *parashikohet 75,428,893 lekë.*

- *Tarifa për gjelbërimin nga familjet 37,950,000 lekë*
- *Tarifa për gjelbërimin nga institucionet 360,000lekë*
- *Tarifa për gjelbërimin nga bizneset 34,374,293lekë*

***Tarifë për mirëmbajtje varrezash 12,744,600 lekë.***

***Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë 31,950,000 lekë.***

- *Tarifa për shërbimet administrative të bashkisë 1,000,000 lekë*
- *Tarifa të kontrollit të zhvillimit të territorit 17,000,000 lekë.*
- *Tarifa e liçensimit të veprimtarive të transportit 500,000 lekë.*
- *Tarifa e parkimit për mjetet e liçensuara dhe vendparkime publike*
- *Tarifa për pyjet dhe kullotat 1,000,000 lekë.*
- *Tarifa për shërbimet shtesë nga zjarrfiksja MNZ 400,000 lekë.*
- *Tarifa për zënien dhe përdorimin e hapësirës publike 10,000,000 lekë.*
- *Tarifa për linjat ajrore dhe nëntokësore ( telefoni, internet) 2,050,000 lekë.*
- *Tarifa të tjera 7110599*

***Tarifa të institucioneve të arsimit, kulturës 11,374,000 lekë.***

- *Qendra Kulturore e femijëve 380,000 lekë*
- *Pallati i Sportit 350,000 lekë*
- *Çerdhet dhe Kopshtet 5,544,000 lekë*
- *Tarifa për furnizimin me ujë dhe kanalizime 500,000 lekë.*
- *Ndërmarrja NMI 4,600,000 lekë.*

***Të ardhurat e tjera parashikohen në vlerën 21,127,784 lekë.***

- *Qeraja nga asetet në pronësi të bashkisë Pogradec 17,127,784 lekë.*
- *Kundërvajtjet administrative (Gjobat) 3,000,000 lekë.*
- *Të tjera ( ndikimi në mjedis) 1,000,000 lekë.*

***Të ardhurat nga taksat e ndara përllogaritet në vlerën 46,700,000 lekë.***

- *Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë përllogaritet 2,500,000 lekë.*
- *Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorurapërllogaritet24,000,000 lekë.*
- *Renta Minerare 5% përllogaritet200,000 lekë.*
- *Tatimi mbi të Ardhurat Personale 2% përllogaritet20,000,000 lekë.*

**Taksat dhe Tarifat Vendore:**

**Taksat Vendore**

Taksat vendore përfshijnë taksa mbi pasurinë e paluajtshme, në të cilën përfshihen taksa mbi ndërtesat, taksa mbi tokën bujqësore dhe taksa mbi truallin, si dhe mbi transaksionet e kryera me to.
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme parashikohet në vlerën 94,107,647 lekë.

## TAKSA E NDËRTESËS

Taksa mbi ndërtesën për vitin 2025 planifikohet të jetë në vlerën *83,339,447* lekë dhe më specifikisht:

Në Njësinë Administrative Pogradec, për vitin 2025, planifikohet të arkëtohen nga taksa e ndërtesës 51,500,000 lekë, konkretisht:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË · BASHKIA POGRADEC

Në Njësinë Administrative Pogradec, planifikohet të arkëtohet vlera18,500,000 lekë, për 1,293 njësi pronësore për qëllime biznesi me sipërfaqe 79,772 m², detajohet si më poshtë:

- 17,750 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore mbi 50 milion lekë.
- 9,919 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 14-50 milion lekë.
- 7,234 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 8-14 milion lekë.
- 4,760 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 5-8 milion lekë.
- 7,559 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 2-5 milion lekë.
- 32,500 m² sipërfaqe për subjekte me xhiro vjetore 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit apo individëve, të cilët zotërojnë njësi pronësore të destinuara për aktivitet social-ekonomik, si dhe nga njësitë pronësore në të cilat nuk ushtrohet aktivitet,pritet të arkëtohet vlera 1,589,234 lekë.
Nga familjarët e Bashkisë Pogradec planifikohet të arkëtohen 33,000,000 lekë për 1,033,196 m² sipërfaqe ndërtim e destinuar për banim.

Në Njësinë Administrative Velçan, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës me vlerë1,563,150 lekë, konkretisht:
Pritet të arkëtohet vlera prej 651,150 lekësh, nga subjektet aktive të cilat ushtrojnë aktivitet me sipërfaqe 3,127 m$^2$:

- 1978 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 124 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 152m$^2$ sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 873 m$^2$ sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e ndërtesës pritet të arkëtohet vlera prej 186,197 lekësh.
Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 912,000 lekësh për një sipërfaqe totale prej 70,222 m$^2$.

Në Njësinë Administrative Trebinjë nga taksa mbi ndërtesën pritet të arkëtohen 473,000 lekë dhe konkretisht:
Vlera prej 56,000 lekësh nga 595 m$^2$ sipërfaqe ndërtese të subjekteve aktive që ushtrojnë aktivitet:

- 300 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për 4 biznese me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 295 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për 11 bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Për taksën e ndërtesës për familje në Njësinë Administrative Trebinjë planifikohet të arkëtohet vlera prej 417,000 lekësh nga për një sipërfaqe totale prej 33, 810 m$^2$.
Nga debitorët e subjekteve të biznesit në Njësinë Administrative Trebinjë pritet të arkëtohet vlera prej 15,359 lekësh për taksën e ndërtesës.

***Në Njësinë Administrative Proptisht***, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës me vlerë 1,440,747lekë, konkretisht:
Pritet të arkëtohet vlera prej 290,747 lekësh nga 1104 m$^2$ sipërfaqe e 46subjekteve aktive që ushtrojnë aktivitet:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

- 60 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 100 m² sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 20 m² sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 924 m² sipërfaqendërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit në Njësinë Administrative Proptisht, në vitin 2025, pritet të arkëtohet vlera prej 142,005 lekësh.
Për Taksën e Ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 1,150,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 83,205 m².

***Në Njësinë Administrative Dardhas***, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës me vlerë 910,000 lekë, konkretisht:
Pritet të arkëtohet vlera prej 280.000 lekësh nga subjektet aktive që ushtrojnë aktivitet në sipërfaqe totale 1678 m²dhe konkretisht:

- 286 m² sipërfaqe ndërtesë për 2 bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 1392 m²sipërfaqe ndërtesë për 22 bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit pritet të arkëtohet vlera prej 50,658 lekësh.
Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 630,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 50,980 m².

***Në Njësinë Administrative Çërravë***, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës në vlerën3,952,550 lekë, konkretisht:
Pritet të arkëtohet vlera prej 900,000 lekësh nga subjektet aktive që ushtrojnë aktivitet në sipërfaqe totale 6,577 m² dhe konkretisht:

- 1742 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 318 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 255 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 545 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 496 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 3221 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e ndërtesës pritet të arkëtohet vlera prej 248,580 lekësh.
Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 3,052,550 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 247,571 m².

***Në Njësinë Administrative Udënisht*** planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës në vlerën 5,300,000 lekë, konkretisht:
Vlera prej 3,300,000 lekësh nga subjektet aktive që ushtrojnë aktivitet në një sipërfaqe totale prej 16,669 m² dhe konkretisht:

- 1775 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 1235 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 900 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 3619 m² sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

- 1195 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 7945 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e ndërtesës pritet të arkëtohet vlera prej 1,221,843 lekësh.
Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 2,000,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 146,944 m$^2$.

***Në Njësinë Administrative Buçimas*** planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e ndërtesës në vlerën 18,200,000 lekë, konkretisht:
Vlera prej 8,000,000 lekësh nga subjektet aktive që ushtrojnë aktivitet në një sipërfaqe totale prej 27,951m$^2$ dhe konkretisht:

- 503 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 14,539 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 1,274 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 1,506 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 2,832 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 7,297 m$^2$ sipërfaqe ndërtesë për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e ndërtesës pritet të arkëtohet vlera prej 3,059,900 lekësh.
Për taksën e ndërtesës për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 10,200,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 468,497 m$^2$.

***Efekti ekonomik i përjashtimeve për taksën mbi ndërtesën.***

Në Njësinë Administrative Pogradec14,167 familje kanë gjendjen civile, nga të cilat 11,500 famije janë rezidente.
Përjashtohen nga taksa e ndërtesës 409 familje që trajtohen me ndihmë ekonomike, 1,555 familje pensionistësh, si dhe 649 familje me kryefamiljarë të vetmuar.

Në Njësinë Administrative Velçan 1,030 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, 785 familje janë rezidente.
214 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje me pensionistë përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Trebinjë, 1,007 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, 512 familje janë rezidente.
199 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje me pensionistë përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Proptisht 2,017 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, 1,351 familje janë rezidente.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... BASHKIA POGRADEC

414 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje me pensionistë **përjashtohen nga taksa e ndërtesës.**

Në Njësinë Administrative Dardhas 1198 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile 638 familje janë rezidente.
228 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh **përjashtohen nga taksa e ndërtesës.**

Në Njësinë Administrative Çërravë,3214 familje kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile 2,500 familje janë rezidente.
656 familje trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Udënisht, 2,722 familje kanë gjendjen civile dhe 2,000 familje janë rezidente, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile.
437 familje trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh përjashtohen nga taksa e ndërtesës.

Në Njësinë Administrative Buçimas, 6554 familje kanë gjendjen civile dhe 4539 familje janë rezidente, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile.
577 familje trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 431 familje pensionistëshpërjashtohen nga taksa e ndërtesës.

## TAKSA MBI TRUALLIN

Taksa mbi truallin për vitin 2025 planifikohet të jetë në vlerën 24,672,790 lekë.

Bazaetaksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në $m^2$, në pronësi apo përdorim të taksapaguesit. Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

*Bashkitë ndodhen në mungesë të bazës së të dhënave për këtë taksë si dhe në pritje të akteve ligjore plotësuese për taksimin e truallit, si një taksë qëndrore për t'u aplikuar nga njësitë vendore dhe si rrjedhim, planifikimi bazohet në të dhëna historike dhe trendin vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit.*

Kjo taksë planifikohet të arkëtohet:

Në Njësinë Administrative Pogradec, për vitin 2025, planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e truallit vlera prej 2,020,000 lekë, nga të cilat:
Njësi pronësore biznese me 97,948 $m^2$ sipërfaqe truall dhe vlerë prej 1,620,000 lekësh nga:

- 16,763 $m^2$ sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore mbi 50 milion lekë.
- 7,243 $m^2$ sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 14-50 milion lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

- 6,161 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 8-14 milion lekë.
- 5,550 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 5-8 milion lekë.
- 11,978 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 2-5 milion lekë.
- 50,253 m² sipërfaqe truall për subjekte me xhiro vjetore 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e truallit pritet të arkëtohet vlera 180,563 lekë për vitin 2025.
Për taksën e truallit për familje për vitin 2025 planifikohet të arkëtohet vlera prej 400,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 1,078,552m$^2$ .
Në Njësinë Administrative Pogradec14,167 familje kanë gjendjen civile, nga të cilat 11,500 familje janë rezidente.

Në Njësinë Administrative Trebinjë, për vitin 2025, planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e truallit vlera prej 50,720 lekë, nga të cilat:
Njësi pronësore biznese me 1,596 m$^2$ sipërfaqe dhe vlerë prej 20,520lekësh nga:

- 300 m$^2$ sipërfaqe trualli për 4 bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 1,296 m$^2$ sipërfaqe trualli për 11 bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit pritet të arkëtohet vlera prej 1,368 lekësh për vitin 2025.
Për taksën e truallit për familjepër vitin 2025 planifikohet të arkëtohet vlera prej 30,200 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 150,650 m$^2$ .
Në Njësinë Administrative Trebinjënga 1,007 familje që kanë gjendjen civile, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, 512 famile janë rezidente.

Në Njësinë Administrative Proptisht, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e truallit me vlerë 208,380 lekë, konkretisht:
Pritet të arkëtohet vlera prej 136,080 lekësh nga 1,370 m$^2$ sipërfaqe e 46 subjekteve aktive që ushtrojnë aktivitet:

- 60 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 100 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 20 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 1.190m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit në Njësinë Administrative Proptisht, në vitin 2025, pritet të arkëtohet vlera prej 119,640 lekësh.
Për Taksën e truallit për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 72,300 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 329,400 m$^2$ .

Në Njësinë Administrative Dardhas, planifikohet të arkëtohen të ardhura nga taksa e truallit me vlerë 110,000 lekë, konkretisht:
Pritet të arkëtohet vlera prej 80,000 lekësh nga 6,470 m$^2$ sipërfaqe truall e subjekteve aktive që ushtrojnë aktivitet:

- 416 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 6,054m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e subjekteve të biznesit për taksën e truallit në Njësinë Administrative Proptisht, në vitin 2025, pritet të arkëtohet vlera prej 7,968 lekësh.

Për Taksën e truallit për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 30,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 148,919 m$^2$ .

Në Njësinë Administrative Çerravë, planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e truallit vlera prej 539,100lekë, nga të cilat:
Njësi pronësore biznese me 27,383 m$^2$ sipërfaqe truall me vlerë 402,000 lekë nga:

- 14,906m$^2$sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 1,680 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 622 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 1,316 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 1,256 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 7,603 m$^2$sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë

Nga debitorët e subjekteve të biznesit pritet të arkëtohet vlera prej 73,404 lekësh.
Për taksën e truallit për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 137,100 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 685,119m$^2$.

Në Njësinë Administrative Udënisht, planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e truallit në vlerën700,000 lekë, nga të cilat:
123 Njësi pronësore biznese me 35,946 m$^2$ sipërfaqe truall, me vlerë 600,000 lekë nga:

- 3,759m$^2$sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 637 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 2,340 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 10,250 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 985 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 17,975 m$^2$sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë

Nga debitorët e subjekteve të biznesit pritet të arkëtohet vlera prej 125,740 lekësh.
Për taksën e truallit për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 100,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 444,089 m$^2$.
Në Njësinë Administrative Udënisht, 2,722 familje kanë gjendjen civile dhe 2,000 familje janë rezidente, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile.

Në Njësinë Administrative Buçimas, planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e truallit vlera prej 1,400,000 lekë, nga të cilat:
1,200,000 lekë nga 310 Njësi pronësore biznese me 76,354 m$^2$ sipërfaqe truall nga:

- 15,042 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 18,804 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 11,196 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 7,645 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 9,909m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 13,758 m$^2$ sipërfaqe trualli për bizneset me xhiro 0-2 milion lekë

Nga debitorët e subjekteve të biznesit pritet të arkëtohet vlera prej 285,897 lekësh.

Për taksën e truallit për familje planifikohet të arkëtohet vlera prej 200,000 lekësh, për një sipërfaqe totale prej 896,415m$^2$.
Në Njësinë Administrative Buçimas, 6,554 familje kanë gjendjen civile dhe 4,539 familje janë rezidente, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile.

## TAKSA MBI TOKËN BUJQËSORE

***Taksa mbi tokën bujqësore për vitin 2025 është planifikuar në vlerën5,515,000 lekë.***

Në Njësinë Administrative Trebinjë planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e tokës bujqësore, vlera prej 242,000 lekë, për sipërfaqen 2,411,922 m$^2$.

Në Njësinë Administrative Proptisht planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e tokës bujqësore, vlera prej 810,000 lekë, për sipërfaqen 7,116,582 m$^2$ tokë bujqësore.

Në Njësinë Administrative Dardhas planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e tokës bujqësore, vlera prej 364,000 lekë, për sipërfaqen 3,637,209 m$^2$ tokë bujqësore.

Në Njësinë Administrative Çërravë planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e tokës bujqësore, vlera prej 1,936,000 lekë, për sipërfaqen 19,357,583 m$^2$ tokë bujqësore.

Në Njësinë Administrative Udënisht planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e tokës bujqësore, vlera prej 400,000 lekë, për sipërfaqen 2,841,337 m$^2$ tokë bujqësore.

Në Njësinë Administrative Buçimas planifikohen të arkëtohen të ardhura nga taksa e tokës bujqësore, vlera prej 1,400,000 lekë, për sipërfaqen 9,235,038 m$^2$ tokë bujqësore.

## TAKSA E TABELËS;

Taksa e tabelës aplikohet për tre lloje tabelash, të përcaktuara sipas qëllimit të përdorimit dhe mënyrës së vendosjes së tyre:

-Tabela për qëllime identifikimi, mbi 2 metra katror, të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës ose brenda territorit ku zhvillon aktivitet biznesi dhe që nuk përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve. Në të tilla tabela vendoset emri dhe/ose lloji i aktivitetit të kompanisë. Tabelat me sipërfaqe më të vogël se 2 m² nuk taksohen.

-Tabela për qëllime reklamimi, ku përfshihen tabelat që nuk janë brenda territorit të biznesit ose nuk janë të trupëzuara në sipërfaqen e ndërtesës, dhe që mund të jenë të thjeshta ose elektronike dhe që përdoren për të reklamuar aktivitetin e të tretëve.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

-Tabela për qëllime ekspozimi, ku përfshihen tabelat me karakter të përkohshëm, për ekspozime të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj.

Në Njësinë Administrative Pogradec, për vitin 2025, për taksën e tabelës përllogaritet të arkëtohen 3,800,000 lekë dhe konkretisht:
Nga taksa e tabelës për qëllime identifikimi 1,800,000 lekë.
Nga taksa e tabelës për qëllime reklamimi 2,000,000 lekë.

Për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Velçan, për vitin 2025, përllogaritet të arkëtohen 3,480 lekë nga taksa e tabelës për qëllime identifikimi.
Nga debitorët për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Velçan pritet të arkëtohet vlera prej 840 lekësh.

Për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Trebinjë , për vitin 2025 përllogaritet të arkëtohen 1,680 lekë.
Nga debitorët për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Trebinjë pritet të arkëtohet vlera prej 360 lekësh.

Për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Proptisht , për vitin 2025 përllogaritet të arkëtohen 1,780 lekë.
Nga debitorët për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Proptisht pritet të arkëtohet vlera prej 1,660 lekësh.

Për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Dardhas, për vitin 2025 përllogaritet të arkëtohen 3,400 lekë.
Nga debitorët për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Dardhas pritet të arkëtohet vlera prej 360 lekësh.

Për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Çerravë, për vitin 2025 përllogaritet të arkëtohen 510,000 lekë , nga :
Taksa e tabelës për qëllime identifikimi vlera e pritshme 15,000 lekë.
Taksa e tabelës për qëllime reklamimi vlera e pritshme 495,000 lekë.
Nga debitorët për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Çerravë pritet të arkëtohet vlera prej 4,080 lekësh.

Për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Udënisht, për vitin 2025 përllogaritet 1,410,500 lekë, nga :
Taksa e tabelës për qëllime identifikimi vlera e pritshme 38,000 lekë.
Taksa e tabelës për qëllime reklamimi vlera e pritshme 1,372,500 lekë.
Nga debitorët për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Udënisht pritet të arkëtohet vlera prej 23,020 lekësh.

Për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Buçimas, për vitin 2025 përllogaritet të arkëtohen 1,182,000 lekë , nga :

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Taksa e tabelës për qëllime identifikimi vlera e pritshme 300,000 lekë.
Taksa e tabelës për qëllime reklamimi vlera e pritshme 882,000 lekë.
Nga debitorët për taksën e tabelës në Njësinë Administrative Buçimas pritet të arkëtohet vlera prej 68,025 lekësh.

## TAKSA E FJETJES NË HOTEL

Planifikimi i të ardhurave për vitin 2025 i taksës së fjetjes në hotel, është bazuar në numrin e njësive që japin strehim kundrejt pagesës dhe përfshin emërtimet hotel, motel, stabiliment turistik, pension, shtëpi pritjeje, turizëm familjar dhe çdo objekt tjetër që përdoret për këtë qëllim, si dhe kapacitet akomoduese të tyre.

Në Bashkinë Pogradec kapaciteti akomodues është 381 dhoma dhe 762 shtretër.

Në Njësinë Administrative Pogradec, pritet të arkëtohen nga taksa e fjetjes në hotel, 4,300,000 lekë, nga 66 subjekte që ushtrojnë veprimtari ekonomike si Bar- Restonant- Hotel, nga të cilat:

- 6 subjekte me xhiro 14-50 milon lekë
- 6 subjekte me xhiro 8-14 milion lekë
- 5 subjekte me xhiro 5-8 milion lekë
- 12 subjekte me xhiro 2-5 milion lekë
- 37 subjekte me xhiro 0-2 milion lekë

Në Njësinë Administrative Udënisht, pritet të arkëtohen nga taksa e fjetjes në hotel 520,000 lekë, nga 30 subjekte Bar- Restonant- Hotele.
Nga subjektet debitorë për taksën e fjetjes në hotel në Njësinë Administrative Udënisht pritet të arkëtohen 516,600 lekësh.

Në Njësinë Administrative Buçimas pritet të arkëtohen nga taksa e fjetjes në hotel vlera 2,800,000 lekë, nga 52 subjekte Bar- Restonant- Hotele nga të cilat:

- 3 me xhiro 14-50 milon lekë
- 5 me xhiro 8-14 milion lekë
- 3 me xhiro 5-8 milion lekë
- 10 me xhiro 2-5 milion lekë
- 31 me xhiro 0-2 milion lekë

## TAKSA E NDIKIMIT NË INFRASTRUKTURË

Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja për vitin 2025 planifikohet në vlerën 200,000,000 lekë, parashikim ky i bërë nga Drejtoria e Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit.

## A.2 TARIFAT VENDORE

Vlera e parashikuar për t'u arkëtuar në vitin 2025 nga tarifat vendore përllogaritet në vlerën 316,872,599 lekë.
Tarifat vendore zenë 47 % të totalit të të ardhurave që planifikohen të arkëtohen gjatë vitit 2025.

## 1.TARIFA E PASTRIMIT

Vlera e parashikuar për t'u arkëtuar në vitin 2025 nga tarifa e pastrimit përllogaritet në vlerën 155,230,606 lekë.

**Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:**

Në Njësinë Administrative Pogradec, për vitin 2025, planifikohet të arkëtohen nga tarifa e pastrimit, 85,320,000 lekë dhe konkretisht:
Nga 1,293 subjekte që ushtrojnë aktivitet ekonomik, pritet të arkëtohen 41,600,000 lekë, nga të cilat:

- 93 subjekte me xhiro vjetore mbi 50 milion lekë.
- 51 subjekte me xhiro vjetore 14-50 milion lekë.
- 48 subjekte me xhiro vjetore 8-14 milion lekë.
- 91 subjekte me xhiro vjetore 5-8 milion lekë.
- 165 subjekte me xhiro vjetore 2-5 milion lekë.
- 845 subjekte me xhiro vjetore 0-2 milion lekë.

Nga subjektet debitorë për tarifën e pastrimit, për vitin 2025, përllogaritet të arkëtohen 2,680,779 lekë.
Për tarifën e pastrimit, për vitin 2025, nga institucionet përllogaritet të arkëtohen 720,000 lekë.
Për tarifën e pastrimit nga familjet , për vitin 2025, përllogaritet të arkëtohen43,000,000 lekë nga 3200 familje.
Në Njësinë Administrative Pogradec 14167 familje kanë gjendjen civile, nga të cilat 11,500 familje janë rezidente, sipas të dhënave nga Sektori i Gjendjes Civile.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Tarifa e pastrimit që planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Velçan për vitin 2025 përllogaritet 3,330,000 lekë, konkretisht:

Në Njësinë Administrative Velçan, vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet nga 27subjektet që ushtrojnë aktivitet është 2,600,000 lekë, nga të cilat:

- 8 biznese me xhiro 14-50 milion lekë
- 1 biznes me xhiro 8-14 milion lekë
- 1 biznes me xhiro 2-5 milion lekë
- 17 biznese me xhiro 0-2 milion lekë

Nga debitorët e biznesit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 1, 052,200 lekë.
Në Njësinë Administrative Velçan, vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për familje është 730,000 lekë.
Sipas të dhënave të marra ngaSektori i Gjendjes Civile, në Njësinë Administrative Velçan kanë gjendjen civile 1,030 familje, nga të cilat 785 familje rezidente.

Tarifa e pastrimit që planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Trebinjë për vitin 2025 përllogaritet 1,897,626 lekë, nga të cilat:

Në Njësinë Administrative Trebinjë pritet të arkëtohet 1,416,626 lekë për 15 subjektet që ushtrojnë aktivitet dhe konkretisht:

- 4 bizneseme xhiro mbi 50 milion lekë.
- 11 bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e biznesit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 3,240 lekë.
Në Njësinë Administrative Trebinjë vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për familje është 481,000 lekë.
Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, në Njësinë Administrative Trebinjë kanë gjendjen civile 1,007 familje, nga të cilat 512 familje rezidente.

Tarifa e pastrimit që planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Proptisht për vitin 2025 përllogaritet 3,879,980 lekë, nga të cilat:
Në Njësinë Administrative Proptisht vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për 46 subjektet që ushtrojnë aktivitet është 2,800,000lekë:

- 5 biznese me xhiro mbi 50 milion lekë
- 1 biznes me xhiro 14-50 milion lekë
- 4 biznese me xhiro 8-14 milion lekë
- 2 biznese me xhiro 5-8 milion lekë
- 1 biznes me xhiro 2-5 milion lekë
- 33 biznese me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e biznesit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 1,286,980 lekë nga tarifa e gjelbërimit.
Në Njësinë Administrative Proptisht vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për familje është 1,079,980 lekë.

Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, në Njësinë Administrative Proptisht kanë gjendjen civile 2,017 familje, nga të cilat 1,351 familje rezidente.

Tarifa e pastrimit që planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Dardhas për vitin 2025 përllogaritet 996,000 lekë, nga të cilat:
Në Njësinë Administrative Dardhas vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për 25 subjektet që ushtrojnë aktivitet është 454,000 lekë:

- 1 biznes me xhiro mbi 50 milion lekë
- 2 biznese me xhiro 2-5 milion lekë
- 22 biznese me xhiro 0-2 milion lekë

Nga debitorët e biznesit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 3,300 lekë.
Në Njësinë Administrative Dardhas vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për familje është 542,000 lekë.
Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, në Njësinë Administrative Dardhas kanë gjendjen civile 1,198 familje, nga të cilat 638 familje rezidente.

Tarifa e pastrimit që planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Çërravë në vitin 2025 përllogaritet 10,307,000 lekë, nga të cilat:
3,900,000 lekënga 91 subjektet që ushtrojnë aktivitet ekonomik dhe konkretrisht:

- 10 bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 2 bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 4 bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 7 bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 6 bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 62 bizneset me xhiro 0-2 milion lekë

Nga debitorët e biznesit për tarifën e pastrimit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 1,139,862 lekë.
Në Njësinë Administrative Çërravë vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për tarifën e pastrimitpër familje është 6,407,000 lekë.
Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, në Njësinë Administrative Çërravë kanë gjendjen civile 3,214 familje, nga të cilat 2,500 familje rezidente.

Tarifa e pastrimit që planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Udënisht, në vitin 2025 përllogaritet 14,500,000 lekë, nga të cilat:
Në Njësinë Administrative Udënisht vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet nga 123 subjektet që ushtrojnë aktivitet është 5,500,000 lekë:

- 9 biznese me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 6 biznese me xhiro 14-50 milion lekë.
- 2 biznese me xhiro 8-14 milion lekë.
- 8 bizneseme xhiro 5-8 milion lekë.
- 11 bizneseme xhiro 2-5 milion lekë.
- 87 biznese me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e biznesit për tarifën e pastrimit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 761,600 lekë.
Në Njësinë Administrative Udënisht vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për tarifën e pastrimit për familje është 9,000,000 lekë.

Në Njësinë Administrative Udënisht, 2,722 familje kanë gjendjen civile dhe 2,000 familje janë rezidente, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile.

Tarifa e pastrimit që planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Buçimasnë vitin 2025 përllogaritet 35,000,000 lekë, nga të cilat:
Në Njësinë Administrative Buçimas vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet nga 310 subjektet që ushtrojnë aktivitet është 14,500,000 lekë:

- 24 bizneset me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 15 bizneset me xhiro 14-50 milion lekë.
- 13 bizneset me xhiro 8-14 milion lekë.
- 14 bizneset me xhiro 5-8 milion lekë.
- 35 bizneset me xhiro 2-5 milion lekë.
- 209 bizneset me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e biznesit për tarifën e pastrimit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 1,714,096 lekë.
Në Njësinë Administrative Buçimas vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për tarifën e pastrimit për familje është 20,500,000 lekë.
Në Njësinë Administrative Buçimas 6,554 familje kanë gjendjen civile dhe 4,539 familje janë rezidente, sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile.

**Efekti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e pastrimit.**

~~Për vitin 2025 efekti financiar nga përjashtimet apo lehtësitë fiskale përllogaritet në vlerën prej 15,369,400 lekë.~~

Bazuar në VKB nr. 133, datë 11.12.2023 për "Miratimin e taksave dhe tarifavevendore në Bashkinë Pogradec",i ndryshuar, përjashtohen nga tarifa e pastrimit si më poshtë:

Përjashtohen nga pagesa e tarifave të pastrimit, gjelbërimit dhe ndriçimit OJF-të.
Për bizneset e reja, të cilat punësojnë mbi 25 punonjës dhe për bizneset e reja që hapen nga individe deri në moshën 25 vjeçare ,tarifat vendore reduktohen në masën 25 % në vitin e parë të aktivitetit.
Për bizneset e reja, të cilat administrohen nga gratë, tarifat vendore reduktohen në masën 20% për vitin e parë.
Bizneset që zhvillojnë aktivitet për punime artizanale përjashtohen nga tarifat.
Për familjet që janë në ndihmë ekonomike paguajnë 70% të tarifave.
Pensionistët e vetmuar, të regjistruar në Gjendjen Civile dhe rezidentë në Bashkinë Pogradec, paguajnë 70% të tarifave.
Gratë kryefamiljare të cilat nuk janë në marrëdhënie pune dhe pensionistet vetëm,pa bashkëshortin/bashkëshorten, përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore.
Nuk do të paguhet tarifa në fshatrat e Njësive Administrative, në të cilat është e pamundur të ofrohet shërbimi i pastrimit për shkak të infrastukturës.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC

Qytetarë të cilët kanë gjëndjen civile në Bashkinë Pogradec, nuk kanë shtëpi banimi në pronësi të tyre dhe nuk janë rezidente në Pogradec përjashtohen nga pagesa e tarifave vendore.

Në Njësinë Administrative Pogradec 14167 familje kanë gjendjen civile, nga të cilat 11,500 familje janë rezidente, sipas të dhënave nga Sektori i Gjendjes Civile.
2,667 familje përjashtohen nga tarifa e pastrimit pasi nuk u ofrohet ky shërbim.
409 familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, 1555 familje pensionistësh si dhe 649 familje me kryefamiljarë të vetmuar, përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e pastrimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtesime për vitin 2025, llogaritet në 5,499,200 lekë.

Në Njësinë Administrative Velçan 245 familje përjashtohen nga tarifa e pastrimit pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 214 familje që trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënavetë marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe 50 familje pensionistesh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e pastrimit.

Në Njësinë Administrative Trebinjë, 495 familje përjashtohen nga tarifa e pastrimit pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 199 familje që trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe50 familje pensionistesh, përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e pastrimit.

Në Njësinë Administrative Proptisht 666 familje përjashtohen nga tarifa e pastrimit pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 414 familje që trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe 50 familje pensionistesh pensionistesh, përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e pastrimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtesime për vitin 2025, llogaritet në 357,280 lekë.

Në Njësinë Administrative Dardhas 576 familje përjashtohen nga tarifa e pastrimit pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 228 familje që trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe 50 familje pensionistesh, përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e pastrimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtesime për vitin 2025, llogaritet në 214,060 lekë.

Në Njësinë Administrative Çërravë, 714 familje përjashtohen nga tarifa e pastrimit pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 656 familje që trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe 50 familje pensionisteshpërfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e pastrimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtësime për vitin 2025, llogaritet në 1,383,760 lekë.

Në Njësinë Administrative Udënisht, përjashtohen nga tarifa e pastrimit 722 familje, pasi nuk u ofrohet ky shërbim.
437 familje që trajtohen me ndihme ekonomike si dhe 50 familje pensionistesh (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e pastrimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtësime për vitin 2025, llogaritet në 1,636,320 lekë.

Në Njësinë Administrative Buçimas përjashtohen nga tarifa e pastrimit 2,015 familje, pasi nuk u ofrohet ky shërbim.
577 familje që trajtohen me ndihme ekonomike si dhe 431 familje pensionistesh (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, përfitojnë reduktimose përjashtim nga tarifa e pastrimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtësime për vitin 2025, llogaritet në 3,386,880 lekë.

## 3.TARIFË GJELBËRIMI

Tarifa e gjelbërimit për vitin 2025 planifikohet në vlerën 75,428,893 lekë, sipas të dhënave të marra ngaNdërrmarrjae Parqeve dhe Rekreacionit në Bashkinë Pogradec.

Kjo tarifë planifikohet të arkëtohet nga:

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Pogradec për vitin 2025, planifikohet në vlerën 42,860,000 lekë, konkretisht:
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Pogradec për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 21,000,000 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Pogradec për vitin 2025, nga Institucionet planifikohet 360,000 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Pogradec për vitin 2025, për 3200 familje planifikohet 21,500,000 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e gjelbërimit nga bizneset përllogaritet në vlerën 1,339,141 lekë.

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Velçan për vitin 2025, planifikohet në vlerën 1,692,500 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Velçan për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 1,300,000 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e gjelbërimit nga bizneset përllogaritet në vlerën 526,100 lekë.

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Trebinjë për vitin 2025, planifikohet në vlerën 931,193 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Trebinjë për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 711,193 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Trebinjë në vlerën 1,620 lekë.

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Proptisht për vitin 2025, planifikohet në vlerën 2,285,100 lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Proptisht për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 1,400,000 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Proptisht në vlerën 643,490 lekë.

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Dardhas për vitin 2025, planifikohet në vlerën 474,000 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Dardhas për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 227,000 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Dardhas në vlerën 1,650 lekë.

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Çërravë për vitin 2025, planifikohet në vlerën 5,400,000 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Çërravë për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 1,950,000 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Çërravë për vitin 2025, për familjet planifikohet në vlerën 3,450,000 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e gjelbërimit për biznes në Njësinë Administrative Çërravë në vlerën 569,931 lekë.

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Udënisht për vitin 2025, planifikohet në vlerën 5,286,100 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Udënisht për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 286,100 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Udënisht për vitin 2025, për familjet planifikohet në vlerën 4,000,000 lekë.
Debia qëpritet të arkëtohet nga tarifa e gjelbërimit nga subjektet debitore,nëNjësinë Administrative Udënisht në vlerën 505,600 lekë.

Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Buçimas përvitin 2025, planifikohet në vlerën 16,500,000 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Buçimas për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 7,500,000 lekë.
Tarifa e gjelbërimit në Njësinë Administrative Buçimas për vitin 2025, për familjet planifikohet në vlerën 9,000,000 lekë.
Debiaqë pritet të arkëtohet nga tarifa e gjelbërimit nga subjektet debitore, nëNjësinë Administrative Buçimas në vlerën 857,048 lekë.

**Efekti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e gjelbërimit.**

REPUBLIKA E SHOIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Në Njësinë Administrative Pogradec 14,167 familje kanë gjendjen civile, nga të cilat 11,500 familje janë rezidente, sipas të dhënave nga Sektori i Gjendjes Civile.
2,667 familje përjashtohen nga tarifa e gjelbërimit pasi nuk u ofrohet ky shërbim.
409 familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, 1555 familje pensionistësh si dhe 649 familje me kryefamiljarë të vetmuar, përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e gjelbërimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtesime për vitin 2025, llogaritet në 2,889,600 lekë.

Përjashtohen nga pagesa e kësaj tarife familjet e Njësive Administrative Dardhas, Proptisht, Trebinjë dhe Velçan.

Në Njësinë Administrative Çërravë, 656 familje trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe 50 familje pensionistesh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e gjelbërimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtësime për tarifën e gjelbërimit për vitin 2025, llogaritet në 691,880 lekë.

Në Njësinë Administrative Udënisht, 437 familje trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe 50 familje pensionistesh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e gjelbërimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtësime për tarifën e gjelbërimit për vitin 2025, llogaritet në 681,800 lekë.

Në Njësinë Administrative Buçimas, 577 familje trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe 431 familje pensionistesh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e gjelbërimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtësime për tarifën e gjelbërimit për vitin 2025, llogaritet në 1,411,200 lekë.

## TARIFË NDRIÇIMI

***Tarifa e ndriçimit që planifikohet të arkëtohet nga Bashkia Pogradec për vitin 2025 është në vlerën 41,518,500 lekë, konkretisht:***

Në Njësinë Administrative Pogradec,për vitin 2025,planifikohet të arkëtohen nga tarifa e ndriçimit22,223,000lekë dhe konkretisht:

Nga 1,293 subjekte që ushtrojnë aktivitet ekonomik, pritet të arkëtohen 6,200,000 lekë, nga të cilat:

- 93 subjekte me xhiro vjetore mbi 50 milion lekë.
- 51 subjekte me xhiro vjetore 14-50 milion lekë.
- 48 subjekte me xhiro vjetore 8-14 milion lekë.
- 91 subjekte me xhiro vjetore 5-8 milion lekë.
- 165 subjekte me xhiro vjetore 2-5 milion lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

- 845 subjekte me xhiro vjetore 0-2 milion lekë.

Nga subjektet debitorë për tarifën e ndriçimit, për vitin 2025, përllogaritet të arkëtohen 467,313 lekë.
Për tarifën e ndriçimit, për vitin 2025, nga institucionet përllogaritet të arkëtohen 23,000 lekë.
Për tarifën e ndriçimit nga familjet , për vitin 2025, përllogaritet të arkëtohen 16,000,000 lekë nga 3,200 familje.
Në Njësinë Administrative Pogradec 14167 familje kanë gjendjen civile, nga të cilat 11,500 familje janë rezidente, sipas të dhënave nga Sektori i Gjendjes Civile.

Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Velçan për vitin 2025, planifikohet në vlerën 871,000 lekë.
Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Velçan për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 141,000 lekënga 27subjekte që ushtrojnë aktivitet, konkretisht nga:

- 8 bizneseme xhiro 14-50 milion lekë.
- 1 biznesme xhiro 8-14 milion lekë.
- 1 biznes me xhiro 2-5 milion lekë.
- 17 bizneseme xhiro 0-2 milion lekë.

Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Velçan për vitin 2025, për familjet planifikohet në vlerën 730,000 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e ndriçimit për biznesnë vlerën 52,500 lekë.

Tarifa e ndriçimit në Njësinë AdministrativeTrebinjë për vitin 2025, planifikohet në vlerën 519,000 lekë.
Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Trebinjë për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 69,000 lekë nga subjektet që ushtrojnë aktivitet, konkretisht nga:

- 4 biznese me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 11 biznese me xhiro 0-2 milion lekë.

Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Trebinjë për vitin 2025, për familjet planifikohet në vlerën 450,000 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e ndriçimit për biznes në vlerën 4,500 lekë.

Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Proptisht për vitin 2025 planifikohet në vlerën 1,247,500 lekë.
Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Proptisht për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 200,000lekë nga subjektet që ushtrojnë aktivitet, konkretisht nga:

- 5 biznese me xhiro mbi 50 milion lekë
- 1 biznes me xhiro 14-50 milion lekë
- 4 biznese me xhiro 8-14 milion lekë
- 2 biznese me xhiro 5-8 milion lekë

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

- 1 biznes me xhiro 2-5 milion lekë
- 33 biznese me xhiro 0-2 milion lekë

Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Proptisht për vitin 2025, për familjet planifikohet në vlerën 1,047,500 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e ndriçimit për biznes në vlerën 73,250 lekë.

Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Dardhas për vitin 2025planifikohet në vlerën 557,000 lekë.
Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Dardhas për vitin 2025, për bizneset planifikohet në vlerën 57,000 lekë nga 25 subjektet që ushtrojnë aktivitet, konkretisht nga:

- 1biznes me xhiro mbi 50 milion lekë
- 2 biznese me xhiro 2-5 milion lekë
- 22 biznese me xhiro 0-2 milion lekë

Tarifa e ndriçimit në Njësinë Administrative Dardhas për vitin 2025, për familjet planifikohet në vlerën 500,000 lekë.
Debia që pritet të arkëtohet nga tarifa e ndriçimit për biznes llogaritet në vlerën 6,000 lekë.

Tarifa e ndriçimit planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Çërravë në vitin 2025 përllogaritet 3,789,000 lekë, nga të cilat:
584,000 lekë nga tarifa e ndriçimit nga 91 subjektet që ushtrojnë aktivitet:

- 10 biznese me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 2 bizneseme xhiro 14-50 milion lekë.
- 4 biznese me xhiro 8-14 milion lekë.
- 7 biznese me xhiro 5-8 milion lekë.
- 6 bizneseme xhiro 2-5 milion lekë.
- 62 bizneseme xhiro 0-2 milion lekë

Nga debitorët e biznesit për tarifën e ndriçimit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 170,000 lekë.
Në Njësinë Administrative Çërravë vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për tarifën e ndriçimit për familje është 3,205,000 lekë.
Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, në Njësinë Administrative Çërravë kanë gjendjen civile 3,214 familje, nga të cilat 2,500 familje rezidente.

Tarifa e ndriçimit planifikohet të arkëtohet në Njësinë AdministrativeUdënisht në vitin 2025 përllogaritet 3,662,000 lekë, nga të cilat:
662,000 lekë 123 nga subjekte që ushtrojnë aktivitet është:

- 9 bizneseme xhiro mbi 50 milion lekë.
- 6 bizneseme xhiro 14-50 milion lekë.
- 2 bizneseme xhiro 8-14 milion lekë.
- 8 biznese me xhiro 5-8 milion lekë.
- 11 bizneseme xhiro 2-5 milion lekë.
- 87 biznese me xhiro 0-2 milion lekë

Nga debitorët e biznesit për tarifën e ndriçimit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 128,500 lekë.
Në Njësinë Administrative Udënisht vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për tarifën e ndriçimit për familje është 3,000,000 lekë.
Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, në Njësinë Administrative Udënisht kanë gjendjen civile 2,722 familje, nga të cilat 2,000 familje rezidente.

Tarifa e ndriçimit planifikohet të arkëtohet në Njësinë Administrative Buçimas në vitin 2025 përllogaritet 8,650,000 lekë, nga të cilat:
Në Njësinë Administrative Buçimas vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet nga tarifa e ndriçimit për 310 subjektet që ushtrojnë aktivitet është 1,650,000 lekë:
Në Njësinë Administrative Buçimas vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet nga 310 subjektet që ushtrojnë aktivitet është 14,500,000 lekë:

- 24 biznese me xhiro mbi 50 milion lekë.
- 15 bizneseme xhiro 14-50 milion lekë.
- 13 biznese me xhiro 8-14 milion lekë.
- 14 bizneseme xhiro 5-8 milion lekë.
- 35 bizneseme xhiro 2-5 milion lekë.
- 209 biznese me xhiro 0-2 milion lekë.

Nga debitorët e biznesit për tarifën e ndriçimit pritet që në vitin 2025 të mblidhen 253,906 lekë.
Në Njësinë Administrative Buçimas vlera e përllogaritur që pritet të arkëtohet për vitin 2025, për tarifën e ndriçimit për familje është 7,000,000 lekë.
Sipas të dhënave të marra nga Sektori i Gjendjes Civile, në Njësinë Administrative Buçimas kanë gjendjen civile 6,554 familje, nga të cilat 4,539 familje rezidente.

***Efekti ekonomik i lehtësive dhe përjashtimeve për tarifën e ndriçimit.***

Në Njësinë Administrative Pogradec 14167 familje kanë gjendjen civile, nga të cilat 11,500 familje janë rezidente, sipas të dhënave nga Sektori i Gjendjes Civile.
2,667 familje përjashtohen nga tarifa e ndriçimit, pasi nuk u ofrohet ky shërbim.
409 familje që përfitojnë ndihmë ekonomike, 1555 familje pensionistësh si dhe 649 familje me kryefamiljarë të vetmuar, përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e ndriçimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtesime për vitin 2025, llogaritet në 2,167,200 lekë

Në Njësinë Administrative Velçan 245 familje përjashtohen nga tarifa e ndriçimit pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 214 familje që trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale, si dhe 50 familje pensionistesh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e ndriçimit.

Në Njësinë Administrative Trebinjë 495 familje përjashtohen nga tarifa e ndriçimit, pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 199 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e ndriçimit, bazuar në Paketën Fiskale 2024.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Në Njësinë Administrative Proptisht 666 familje përjashtohen nga tarifa e ndriçimit, pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 414 familje të cilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh **përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e ndriçimit**, bazuar në Paketën Fiskale 2024 , në vlerën 324,800 lekë

Në Njësinë Administrative Dardhas 576 familje përjashtohen nga tarifa e ndriçimit, pasi nuk u ofrohet ky shërbim, 228 familje tëcilët trajtohen me ndihmë ekonomike dhe 50 familje pensionistësh përjashtohen ose iu reduktohet tarifa e ndriçimit, bazuar në Paketën Fiskale 2024 , në vlerën 194,600 lekë

Në Njësinë Administrative Çërravë, 656 familje trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale), si dhe 50 familje pensionistesh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e ndriçimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtësime për tarifën e ndriçimit për vitin 2025llogaritet në 741,300 lekë.

Në Njësinë Administrative Udënisht 437familje trajtohen me ndihme ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale), si dhe 50 familje pensionistesh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e ndriçimit.
Vlera e familjeve që përfitojnë lehtësime për tarifën e ndriçimit për vitin 2025llogaritet 511,350 lekë.

Në Njësinë Administrative Buçimas577 familje trajtohen me ndihme si dhe 431 familje pensionistesh përfitojnë reduktim ose përjashtim nga tarifa e ndriçimit, ekonomike (sipas të dhënave të marra nga Drejtoria e Shërbimeve Sociale).
Vlerae familjeve që përfitojnë lehtësime për tarifën e ndriçimit për vitin 2025 llogaritet në 1,058,400 lekë.

## 4.TARIFË MIRËMBAJTJE VARREZA PUBLIKE

Parashikimi për vitin 2025 për Tarifën e mirëmbajtjes së varrezave publike është planifikuar në vlerën 12,744,600 lekë, sipas të dhënave të marra nga Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturës dhe Punëve Publike.

Kjo vlerë planifikohet të arkëtohet nga:

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Pogradec, për vitin 2025 planifikohet të arkëtohet në vlerën 6,000,000 lekë.

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Velçan për vitin 2025 planifikohet të arkëtohet në vlerën 392,500 lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Trebinjë për vitin 2025 planifikohet në vlerën 220,000 lekë.

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Proptisht për vitin 2025 planifikohet në vlerën 885,100 lekë.

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Dardhas për vitin 2025 planifikohet në vlerën 247,000 lekë.

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Çërravë për vitin 2025 planifikohet në vlerën 1,500,000 lekë.

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Udënisht për vitin 2025 planifikohet në vlerën 1,000,000 lekë.

Tarifa e mirëmbajtjes së varrezave publike në Njësinë Administrative Buçimas për vitin 2025 planifikohet në vlerën2,500,000 lekë.

## TARIFA E SHFRYTËZIMIT TË SIPËRFAQEVE PUBLIKE

Tarifa e shfrytëzimit të sipërfaqeve publike për vitin 2025 është planifikuar në vlerën 10,000,000 lekë, bazuar në parashikimin e Drejtorisë së Planifikimit,Kontrollit dhe Zhvillimit të Territorit, për sipërfaqet dhe zënien e hapësirës publike, të cilat përdoren dhe do të përdoren për qëllime të ndryshme, siç janë zënia e hapësirave publike për shërbim me tavolina jashtë lokalit, vendosje platformash pedana, zënia e hapësirave publike për organizim evente të ndryshme, panaire, zënia e hapësirave publike për kënde lojrash, zenie e hapësirave publike si stacione plazhi.

## TARIFA PËR LINJAT AJRORE DHE NËNTOKSORE (TELEFONI, ENERGJI, TV KABLLOR, INTERNET)

Tarifa për linjat ajrore dhe nëntoksore (Telefoni, Energji, TV Kabllor, Internet) planifikohet të arkëtohen 2,005,000 lekë dhe konkretisht nga :

3 subjekte në Njësinë Administrative Pogradec, me vlerë 750,000 lek.
3 subjekte në Njësinë Administrative Buçimas, me vlerë 600,000 lek
2 subjekte në Njësinë Administrative Udënisht, me vlerë 300,000 lek
1 subjekt në Njësinë Administrative Proptisht, me vlerë 100,000 lek
1 subjekt në Njësinë Administrative Dardhas, me vlerë 100,000 lek

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

1 subjekt në Njësinë Administrative Çërravë,me vlerë 100,000 lek
1 subjekt në Njësinë Administrative Trebinjë, me vlerë 100,000 lek

**TË ARDHURAT E TJERA**

Të ardhurat e tjera, përfshijnë "Të ardhura nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë", si dhe "Të ardhura të tjera nga ndikimi në mjedis".

Në Njësinë Administrative Pogradec për vitin 2025, planifikohen të arkëtohen të ardhura nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë, si dhe nga të ardhura të tjera nga ndikimi në mjedis, vlera prej 400,000 lekë, konkretisht:
Në Njësinë Administrative Pogradec të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2025, përllogariten në vlerën 280,000 lekë.
Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis pritet në vlerën 120,000 lekë.

Në Njësinë Administrative Velçan të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2025, përllogariten në vlerën 5,021,833 lekë konkretisht:
Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisëpër vitin 2025, planifikohen në vlerën 4,841,833 lekë.
Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis pritet në vlerën 180,000 lekë.

Në Njësinë Administrative Trebinjë të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2025, përllogariten në vlerën 2,041,202 lekë, konkretisht:
Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2025, në Njësinë Administrative Trebinjë planifikohen në vlerën 1,961,202 lekë.
Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis pritet në vlerën 80,000 lekë.

Në Njësinë Administrative Proptisht të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2025, përllogariten në vlerën 4,205,000 lekë, konkretisht:
Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2025, në Njësinë Administrative Proptisht planifikohen në vlerën 4,005,000 lekë.
Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis në Njësinë Administrative Proptisht pritet në vlerën 200,000 lekë.

Në Njësinë Administrative Dardhas të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2025, përllogariten në vlerën 904,445 lekë, konkretisht:
Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2025, në Njësinë Administrative Proptisht planifikohen në vlerën 904,445 lekë.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Në Njësinë Administrative Çërravë të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2025, përllogariten në vlerën 695,304 lekë, konkretisht:
Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2025, në Njësinë Administrative Çërravë planifikohen në vlerën 535,304 lekë.
Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis në Njësinë Administrative Çërravë pritet në vlerën 160,000 lekë.
Në Njësinë Administrative Çërravë pritet të arkëtohen nga subjektet debitorë për taksën e ndikimit në mjedis nga 7 subjekte vlera prej 20,000 lekësh.

Në Njësinë Administrative Udënisht të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2025, përllogariten në vlerën 1,900,000 lekë, konkretisht:
Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2025, në Njësinë Administrative Udënisht planifikohen në vlerën 1,800,000 lekë.
Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis në Njësinë Administrative Udënisht pritet në vlerën 100,000 lekë.
NëNjësinë Administrative Udënisht pritet të arkëtohen nga subjektet debitorëpërtaksën e ndikimit në mjedis nga 5 subjekte vlera prej 100,000 lekësh.

Në Njësinë Administrative Buçimas të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë dhe nga tarifa e ndikimit në mjedis për vitin 2025, përllogariten në vlerën 2,940,000 lekë, konkretisht:
Të ardhurat nga qeraja nga asetet në pronësi të Bashkisë për vitin 2025, në Njësinë Administrative Buçimas planifikohen në vlerën 2,800,000 lekë.
Të ardhura nga tarifa e ndikimit në mjedis në Njësinë Administrative Buçimas pritet në vlerën 140,000 lekë.

## TË ARDHURAT NGA TAKSAT E NDARA

Bashkia merr një pjesë të të ardhurave të mbledhura nga qeveria qendrore nga tatimi mbi të ardhurat personale, taksa e regjistrimit të automjeteve dhe renta minerale.

**Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë**

Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme (97 për qind e të ardhurave nga taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasurinë e paluajtshme për individë, personat fizikë dhe juridikë).

Taksa mbi kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme paguhet para kryerjes së regjistrimit nga personi që kalon të drejtën e pronësisë mbi pasurinë e paluajtshme, dhe vendoset për të gjitha pasuritë nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec.
Planifikimi për vitin 2025 do të jetë 2,500,000 lekë, duke ju referuar të dhënave nga Agjensia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Pogradec, e cila në rolin e agjentit tatimor e mbledh këtë taksë dhe e transferon për llogari të pushtetit vendor.
Kjo taksë zë 2.1 % të planifikimit total për vitin 2025.

**Taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura**

Taksa vjetore për qarkullimin e mjeteve të përdorura është pjesë e taksave të ndara.
Njësitë e vetëqeverisjes vendore përftojnë 25% të të ardhurave totale të gjeneruara nga kjo taksë.
*Për vitin 2025 parashikohet të arkëtohet nga Bashkia Pogradec nga taksa për qarkullimin e mjeteve të përdorura vlera 24,000,000 lekë.*

**Renta Minerare**

Çdo person fizik ose juridik, i cili është i liçencuar dhe/ose vepron në industrinë minerare, sipas një marrëdhënieje kontraktuale me ministrin përgjegjëse për këtë fushë, duhet të paguajë qira për burimet natyrore të nxjerra nga, mbi/nën tokën e Republikës së Shqipërisë.
Njësitë e Vetëqeverisjes Vendore ku kryhet aktiviteti marrin 5 përqind e të ardhurave nga renta minerare.
Renta minerare llogaritet si detyrim mujor i subjektit taksapagues, në çastin kur ai shet produkte minerare, 5 për qind e të ardhurave nga renta minerare i takojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria.
Të ardhurat nga renta minerare përdoren për investime për njësitë e qeverisjes vendore.

Për vitin 2025 kjo taksë planifikohet të aktëtohet në vlerën 200,000 lekë, bazuar nga të dhënat e marra nga Drejtoria Rajonale Tatimore Korçë.

**Tatimi mbi të Ardhurat Personale**

Të ardhurat e ndara nga Tatimi mbi të Ardhurat Personale përfshijnë tatimin mbi të ardhurat personale si të nëpunësve publikë, ashtu edhe të atyre të punësuar në sektorin jo-publik si dhe tatimin mbi të ardhurat e krijuara nga individë nga interesi, qiraja, llotaritë, lojërat dhe burime të tjera.

Tatimi mbi të ardhurat personale, llogaritet mbi të ardhurat e individëve.
Njësitë e vetëqeverisjes vendore përfitojnë si taksë të ndarë, 2 (dy) për qind të të ardhurave nga tatimi mbi të ardhurat personale që realizohen në juridiksionin e tyre.
Deri në këto momente kjo ndarje bëhet sipas numrit të popullsisë të Bashkive të përdorur në formulën e transfertës së pakushtëzuar.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Për vitin 2025 ky tatim planifikohet të aktëtohet në vlerën 20,000,000 lekë, duke ju referuar të dhënave historike dhe realizimit të vitit 2024.

## ANALIZA E SHPENZIMEVE PER VITIN AKTUAL DHE PLANI I SHPENZIMEVE PER VITIN 2024

Gjatë vitit 2024, përmes këtyre shpenzimeve të planifikuara, Bashkia Pogradec synon të punojë duke iu përgjigjur objektivave sipas programeve lokale të zhvillimit si dhe detyrimeve dhe funksioneve të përcaktuara me ligj:

- ✓ Administrata vendore
- ✓ Emergjencat civile
- ✓ Zhvillimi i Turizmit
- ✓ Planifikimi, administrimi dhe kontrolli i territorit sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- ✓ Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e rrugëve vendore, trotuareve dhe sheshevе publike vendore;
- ✓ Mbledhja, largimi dhe trajtimi i mbetjeve urbane;
- ✓ Parqet, lulishtet dhe hapësirat e gjelbra publike;
- ✓ Mbledhja dhe largimi i ujërave të shiut dhe mbrojtjen nga përmbytjet në zonat e banuara;
- ✓ Ndërtimi, rehabilitimi dhe mirëmbajtja e varrezave publike si dhe garantimi i shërbimit publik të varrimit;
- ✓ Shërbimi i dekorit publik;
- ✓ Ndriçimi i mjediseve publike
- ✓ Hartimi i planeve dhe programeve për zhvillimin ekonomik lokal;
- ✓ Mbështetja për zhvillimin e biznesit të vogël nëpërmjet veprimtarive nxitëse, të tilla si panaire e reklama në vende publike;
- ✓ Publikim i broshurave informative, krijimit të portaleve me profil ekonomik etj.
- ✓ Administrimi i infrastrukturës vendore të ujitjes dhe kullimit të tokave si dhe menaxhimi i institucioneve në shërbim të këtij funksioni, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj;
- ✓ Administrimi i sistemit të informacionit dhe kadastrës së tokave bujqësore.
- ✓ Krijimi dhe administrimi i sistemit vendor të informacionit dhe këshillimit bujqësor dhe rural,përfshirë statistikat bujqësore vendore, sipas legjislacionit në fuqi.
- ✓ Ndërtimi,rehabilitimi dhe mirëmbajtja e ndërtesave arsimore të sistemit shkollor parauniversitar.
- ✓ Sistemi arsimor parashkollor në kopshte dhe çerdhe.
- ✓ Krijimi dhe administrimi i shërbimeve sociale për shtresat në nevojë, personat me aftësi të kufizuar, fëmijët, gratë, të moshuarit etj., sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- ✓ Administrimin e Qendres Ditore për ofrimin e shërbimeve sociale lokale.
- ✓ Në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për mirëqenien sociale, krijojnë fondin social për financimin e shërbimeve, sipas mënyrës së përcaktuar me ligj.
- ✓ Zhvillimi, mbrojtja dhe promovimi i vlerave dhe trashëgimisë kulturore me interes lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- ✓ Organizimi i aktiviteteve kulturore dhe promovimi i identitetit kombëtar dhe lokal si dhe administrimi i objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.
- ✓ Zhvillimi, mbrojtja, dhe promovimi i bibliotekes dhe ambienteve për lexim me qëllimin e edukimit të përgjithshëm të qytetarëve.
- ✓ Programet dhe projektet rinore.
- ✓ Organizimi i aktiviteteve sportive dhe rekreacionale, zhvillimi dhe administrimi i institucioneve dhe objekteve që lidhen me ushtrimin e këtyre funksioneve.

**BASHKIA POGRADEC**

**Ne fondin e pagave** perfshihen paga dhe sigurime shoqerore e shendetsore ne vleren totale 216,911,670 lekë . Ky plan eshte bere ne baze te numrit te punonjeve dhe nivelit te pagave te miratuar nga Keshilli Bashkiak. Duke marrë parasysh faktin e vitit 2024 dhe gjithashtu rritjen e pagës mesatare kemi parashikuar një rritje rreth 10% të fondit të pagave. Numri i punonjësve të bashkisë në Nëntor të 2024 është 284 punonjës dhe fondi i pagavës në muaj është rreth 19,250,000 lekë.

**Shpenzimet administrative** jane parashikuar 15,880,000 lekë ku përfshihen shpenzime si blerje kancelari, shpenzime telefoni, blerje te cilat jane te domosdoshme per aktivitetin e Bashkise etj . Këto shpezime janë të planifikuar në bazë të nevojave të bashkisë por dhe duke u bazuar tek fakti i vitit 2024. Çmimet e të gjitha produkteve janë rritur në vitin 2024 dhe planifikimi është kryer në bazë të çmimeve të tregut. Pjesë të konsiderueshme zë zëri i Dezinsektim-desinfektim i cili në bazë të përllogaritjeve dhe çmimet e tregut. Në kuadër të programimit të Buxhetit për vitin 2025 Sektori I Shërbimeve Mbështetëse ka paraqitur nevojat për karburant (Naftë-Benzinë) .Bashkia qëndër ka deryrë të furnizojë me karburant këto Drejtori:

-Drejtorine e Taksave (Benzinë)

-Policinë Bashkiake (Benzinë)

-Njësitë Administrative ,për korëset e barit (Benzinë)

-Sektori i MZSH-së (Naftë)

-Njësitë Administrative Proptisht,Buçimas. (Naftë)

-IVMT(Naftë)

-Kabineti(Naftë)

-Emergjencat Civile (Naftë)

-Inspektoriati i Mbrojtjes së Qenve Endacakë(Naftë)

-Drejtoria e Mbrojtjes së Pyjeve dhe Kullotave.(Shtuar Bashkisë në Tetor 2023).

Duke qënë se Bashkia do të krijojë Ndërmarrjen e re të Mbrojtjes së Tërritorit pjesa kryesore e makinave do të transferohet tek kjo ndërmarrje. Prandaj dhe shuma e Karburantit është më e ulët tek fondi i Bashkisë. Por kemi marrë parasysh edhe faktin që bashkia ka një masë të konsiderueshme nafte në dispozicion.

Për vitin 2024 fakti i shpnzuar ka qënë në masën 17,786,284 lekë

**Shpenzimet operative** jane parashikuar 11,140,000 lekë ku përfshihen energji elektrike, uje , telefon, shërbim postar etj. Për vitin 2024 ky zë ka qënë rreth 7,000,000 lekë.

**Shpenzime te tjera** ka nje vlere 51,900,000 leke ku përfshihen shpërblimet e Këshilltarëve, Kryepleqve, Fondi i emergjencave i cili është i detyrueshëm per tu planifikuar, fondi për familjet në nevojë etj. Parashikimin e Fondit te emergjencave duhet te theksoj se ne baze te nenit 65 te ligjit nr 45/2019 "Per mbrojtjen civile", Bashkia duhet te planifikoje min 4% te Buxhetit te Kushtezuar per emergjenca.

Ky zë për vitin 2024 është shpënzuar në masën 13,735,492 lekë duke marrë parasysh dhe ndryshimet në Buxhet të ndodhura përgjatë vitit.

**Kontribute ndaj te treteve** kemi planifikuar rreth 119,460,000 lekë, ku peshën më të madhe e zenë shpenzimet për pagesë për Qarkun, KRWM por gjithashtu dhe shpenzimet për QMP SHA. Një risi këtë vit janë shpenzimet për Akademine e QV, shoqatën e Bashkive dhe Grand Park Drilon.

Ky zë për vitin 2024 është shpenzuar rreth 100,000,000 lekë.

**Sherbimet** kanë vleren totale rreth 162,150,000 lekë. Në këtë zë të shpenzimeve kemi parashikuar sherbimin e pastrimit ne shumen 160,000 mije leke. Shpenzime për regjistrim pasurie dhe shpenzime për qëra toke. Gjithashtu është planifikuar dhe shpenzimi për mirëmbajtje programi kompjuterik.

Ky zë për vitin 2024 është shpenzuar rreth 120,000,000 lekë.

**Shpenzime për evenimente të ndryshme** janë shpenzimet që do të kryhen përgjatë vitit.

## MBI INVESTIMET QE PARASHIKOHEN PER VITIN 2025

| | EMERTIMI I OBJEKTEVE | Objekti | Mbikeqyrje |
|---|---|---|---|
| 1 | Ura e Zëmçës Kryqezimi Proptisht, Bishnice(likujdim) | 80,000,000 | 1,889,384 |
| 2 | Perforcim/ rehabilitim banesash kolektive 2024(likujdim) | 5,500,000 | 314,223 |
| 3 | Shtesa e Sistemimit te Lumit Bucimas(likujdim) | 10,804,812 | 257,993 |
| 4 | Rikonstruksion dhe shtese objekti per shkollen Kajo Karafili Geshtenjas | 15,000,000 | 1,000,000 |
| 5 | Kolaudime 2024 | 2,000,000 | |
| 6 | Sherbim dru zjarri | 7,852,188 | |
| | **SHUMA TOTALE PER INVESTIMET** | **121,157,000** | **3,461,600** |

Investimet e planifikuara janë të gjitha investime të vitit 2024 të cilat janë për tu likujduar për vitin 2025. Përsa i përket investimeve të reja Bashkia ka aplikuar tek FSHZH dhe jo vetëm për rehabilitimin e rrugëve si më poshtë:

1. Rehabilitim i rrugës Shemshi Koroveshi dhe rruga Industriale
2. Rehabilitim i rrugës që lidh Blacë- Alarup- Bratomirë
3. Rehabilitim i rrugës së Letovës

Gjithashtu me anë të NMIPP do të punohet për rehabilitimin e rrugëve:

1. Rehabilitim i rrugës tek Prroi i Çaprazit dhe Varrezat e qytetit
2. Rrugicat në Njësinë Administrative Buçimas
3. Rruga e Hamollëve në Beragozhd dhe lidhja e shkollës me kalçeton

**QENDRA ARSIMORE PRANE BASHKISE**

**1.PAGA DHE SIGURIME JANE LLOGARITUR PER 84 PUNONJES TE NDARE SI ME POSHTE**

**A**.14 punonjes ne cerdhe, 1 pergjegjese, 8 kujdestare, 1 guzhiniere, 1 nd/kuzhiniere, 3 punonjese sherbimi

**B**.12 punonjese sherbimi ne kopshtet e qytetit

**C**.2 guzhiniere ne kopshte

**D**.2 nd/guzhiniere ne kopshte

**E**.40 punonjese sherbimi dhe roje ne njesite administrative+3 punonjes sherbimi(shtese per vitin 2025)

**F**.6 punonjes arsimi

**G. 3** ed/ndihmese + 1 pun/sociale+1 psokologe (shtese per vitin 2025)

**2.KUOTE USHQIMORE KOPESHT DHE CERDHE NE VLEREN 11 880 000**

**A.**KUOTE USHQIMORE KOPESHT NE VLERE 9 504 000 LEK ME TVSH E LLOGARITUR

200 femije * 180 kuota ditore*22 dite * 12 muaj

**B.** KUOTE USHQIMORE ÇERDHE NE VLERE 2 376 000 LEK ME TVSH E LLOGARITUR

60 femije *150 kuota ditore *22 dite *12 muaj

**C.Vlera 3 600 000 eshte llogaritur per blerje te ndryshme per nevojat e QAB.**

D.**Qera ambjenti ne vleren 600 000lek eshte llogaritur per:**

5 ambjente *10 000lek/muaj *12 muaj

| | Emertimet | Plani | I pritshmi |
|---|---|---|---|
| | | 2024 | 2024 |
| 1 | **Paga,sig.shoq** | | |
| | Paga | 52,440,000 | 37,700,000 |
| | Sigurime shoqerore e shendetesore | 8,750,000 | 6,305,000 |
| | **Total 1** | **61,190,000** | **44,005,000** |
| 2 | **Shpenzime administrative** | | |
| | **Kancelari** | 200000 | 200000 |
| | **Total 2** | **200,000** | **200,000** |
| 3 | **Shpenzime operative** | | |
| | Energji elektrike | 4,500,000 | 2,550,000 |
| | Uje | 3,500,000 | 1,500,000 |
| | **Total 3** | **8,000,000** | **4,050,000** |
| 4 | Shpenzime te tjera | 1,920,000 | 1,000,000 |
| | Qera | 500,000 | 300,000 |
| | Kuota ushqimore(cerdhe+kopesht) | 11,870,000 | 9,500,000 |
| | **Total 4** | **14,290,000** | **10,800,000** |
| | **SHUMA** | **83,680,000** | **59,055,000** |

**NDERMARRJA E E PARQEVE DHE REKREACIONIT**

1. Paga

   Eshte rritur fondi per shkak se eshte shtuar vjetersia ne pune e punonjesve si dhe pë shkak të shtesës së pagave në Tetor 2024.

2. Shpenzime operative

-Kancelari, shtypshkrime eshte rritur fondi pasi kemi nevoje per shtimin e disa mallrave si: dosje, boje, leter A4 etj.

-Shpenzime qeraje per kultivimin e fidaneve dhe shkurreve decorative dhe depozitimin e mbetjeve te drureve dhe shkurreve per shndërimin në humus

3. Sherbime te tjera

- Sherbime per prerjen e druve te kalbura qe perbejne rrezik, ne parkun e Qytetit

Nga kqyrja në vend e drurve te parkut dhe analizimi i situates ne bashkepunim me sherbimin pyjor, u vlerësuan drurët sipas shkallës së rrezikshmërisë që ata paraqesin dhe eshte e nevojshme prerja e tyre dhe zevendesimi me fidane te rinj. Duke mos pasur mjetet dhe specialistet per kryerjen e procesit te prerjes lind nevoja i kontraktimit te nje firme te specializuar per kete proces.

4. Shpenzime blerje

- Blerje karburanti

Duke qene se Ndermarrja jone ka aktualisht 4 mjete motorrike si dhe numri i motorsharave dhe makinave korrese eshte shtuar, eshte e nevojshme blerja e nje sasie me te madhe karburanti.

- Blerje plehra kimike, pesticide dhe fare bari

Duke qene se kemi shtuar siperfaqet e mbjella me lule dhe fidana e peme dekorative eshte e nevojshme dhe shtimi e plehrave kimike dhe pesticide per kujdesin ndaj tyre

- Blerje lule natyrale

Per shkak te investimeve dhe projekteve te reja qe do te behen ne qytetin e Pogradecit, ne parkun buze liqenit eshte e nevojshme shtimi i sasise se luleve sezonale natyrale.

- Blerje fidana, peme dekorative dhe shkurre decorative

Nisur nga fakti qe shume peme jane degraduar nga kalbezimi dhe tharja, eshte e nevojshme zevendesimi i tyre.

- Blerje koshash per mbeturinat ne park dhe plazhet publike

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

Ne parkun tone ka mungesa te koshave te mbeturinave dhe per shkak te shtimit te plazheve publike ,lind nevoja për shtimin e fondit per blerjen e koshave.

- Berje lende drusore per riparimin e stolave dhe koshave

Nisur na fakti qe gjate vitit 2024 pati shume demtime te stolave dhe koshave ne park eshte e nevojshme riparimi i tyre me lende drusore ne menyre qe te kthehen ne funksionalitet.

- Blerje bova sinjalizuese tabela sinjalizuese dhe informuese ne plazh gjate sezonit turistik

Per sigurine e pushuesve dhe personave qe praktikojne sportet ujore gjate sezonit turistik eshte e nevoshme blerja e bovave dhe tabelave sinjalizuese per ne liqen.

- Blerje materiale per mirembajtjen e pompave dhe sistemit vadites

Nisur nga fakti qe gjate vitit 2024 patem problem me pompat dhe sistemin vadites eshte I nevojshem mirembajtja dhe riparimi I tyre.

- Blerje flamuj kombetare

Ne kuader te festave dhe ceremonive te ndryshme eshte e novojshme blerja e flamujve per zhvillimin e ketyre aktiviteteve.

- Blerje materiale per mirembajtjen e shtervaneve te qytetit dhe sistemin ujites .

  Per arsye te difekteve te shumta qe kane ndodhur ne vitin 2024, lind nevoja per shtimin e fondeve.

5. Investime

-Blerje beze dhe çadra per plazhet publike me logon e bashkise

Ne kuader te projekteve te reja te bashkise per vitin 2024 eshte e nevojshme blerja e cadrave te plazhit per mobilimin e te gjitha plazheve publike prane bashkise me cadra per banoret dhe pushuesit te cilet frekuentojne plazhet publike ne territorin e bashkise.

-Blerje materiale per sistemin ujites me pika per borduren tek shetitorja 10 Dëshmoret.

Per mirembajtejn sa me te mire te bordures decorative pergjate shetitores, lind nevoja e nje sistemi vadites me pika.

-Blerje material pedane per uren tek Uckat.

Per arsye te incidenteve te shumta qe kane ndodhur gjate sezonit turistik 2024 per arsye te rreshqitshmerise tek ura , del e nevojshme shtrimi saj me pedane kunder rreshqitjes nga lageshtia.

-Blerje Tenda sherbimi me banak

Per organizimet e ndryshme festive nga Bashkia Pogradec, lind nevoja per blerjen e tendave me banak.

-Blerje Kjoska sherbimi.

Per tu ardhur ne ndihme bizneseve qe ekspozojne produktet e tyre dhe ofrojne sherbime gjate celjes se sezonit turistik si dhe festat e ndryshme qe organizon bashkia, lind nevoja per blerjen e disa kjoskave te mbyllura.

-Ndertim tualet per punonjesit e NPR

Tek ambienti I punetoreve tek fidanishtja nevojitet nje tualet per punonjeset.

-Riparim tarrace

Tarraca tek magazina, ngjitur me sallen e Keshillit, ka nevoje per riparim , pasi gjate diteve me rreshje pikon.

| Nr | Emertimet | P/ PLANI 2024 | I Pritshmi 2024 |
|---|---|---|---|
| 1 | **Paga,sigurime shoqërore** | | |
| | Paga | 38,560,000 | 37,920,000 |
| | Sigurime shoqerore | 6,440,000 | 6,322,640 |
| | **Shuma :1** | **45,000,000** | **44,242,640** |
| 2 | **Shpenzime operative** | | |
| | Kancelari, shtypshkrime | 110,000 | 98,600 |
| | Shpenzime uji | 1,100,000 | 600,000 |
| | Shpenzime Energjie | 400,000 | |
| | Udhetim e dieta | 90,000 | |
| | Materiale ngrohje e mirembajtje zyre | | |
| | Sherbime te ndryshme ( kalitje, saldime,riparime) | 100,000 | |

BASHKIA POGRADEC

| | | | |
|---|---|---|---|
| | **Shuma :2** | **1,800,000** | **698,600** |
| 3 | **Sherbime te tjera** | | |
| | Taksa+siguracione | 110,000 | |
| | Shpenzime tjera transporti ( kolaudimi) | 90,000 | 70,850 |
| | Shlyerje detyrime te prapambetura | 400,000 | |
| | Mirembajtje e lapidareve | | |
| | Mirembajtje vepra arti | | |
| | Sherbime mirembajtje e magazines penne fidanishtes | | |
| | Sherbime per prerjen e druve te kalbura qe perbejne rrezik, ne parkun e Qytetit | | |
| | Mirembajtej varrezat e deshmoreve | | |
| | Mirembajtje e lapidareve dhe vepra arti | 200,000 | |
| | **Shuma: 3** | **800,000** | **70,850** |
| 4 | **Shpenzime blerje** | | |
| | Blerje karburant | 1,200,000 | 1,182,000 |
| | Blerje pjese kembimi e vajra per makinat | 300,000 | 285,600 |
| | Blerje materiale te ndryshme per mirembajtjen e kendeve te lojrave,stolave dhe koshave | 625,000 | 540,000 |
| | Blerje plehra kimike,organike,ushqyes,pesticide dhe fare bari | 720,000 | 549,890 |
| | Blerje markuç vaditje | | |
| | Blerje materiale ndertimi dhe bojë | 400,000 | 330,000 |
| | Blerje materiale hidraulike,tubo per sistemin ujites dhe markuç vadites | 450,000 | 306,480 |
| | Blerje rroba pune | 500,000 | 375,360 |
| | Blerje vegla pune | | |
| | Blerje materiale per riparimin e makines | - | |
| | Blerje materiale per riparimin e makinave korrse dhe motorseka | 110,000 | 109,200 |
| | Blerje lule natyrale | 1,100,000 | 1,034,880 |
| | Blerje fare bari | | |
| | Blerje Fidana peme dekorative dhe shkurre dekorative | 1,200,000 | |
| | Blerje vazo dekorative | 300,000 | |
| | Blerje koshash mbeturinash per parkun e qytetit dhe plazhet publike | 500,000 | |
| | Blerje lende drusore per riparimin e stolave dhe koshave | | |
| | Blerje materiale te ndryshme per impiantin vadites tek ODEONI | | |
| | Blerje bova sinjalizuese per ne liqen gjate sezonit turistik | | |
| | Blerje tabela sinjalizuese dhe informuese ne plazh per sezonin turistik | | |
| | Blerje stolash per parkun e qytetit | 1,200,000 | |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË ... BASHKIA POGRADEC

| | | | |
|---|---|---|---|
| | Blerje pjese kembimi per mirembajtjen e riparimin e bicikletave te ndermarrjes | | |
| | Blerje materiale per mirembajtjen e shatrivaneve te qytetit dhe pompave sistemin vadites | 550000 | 54000 |
| | Blerje materiale per mirembajtjen e pompave dhe sistemin vadites | | |
| | Blerje shkurre dekorative | | |
| | Blerje materiale te ndryshme per mirembajtjen e zyres dhe ambienteve te punetoreve | 120000 | |
| | Blerje flamuj kombetare dhe banderola per festat dhe flamuj me stemen e bashkise | 360000 | 286080 |
| | Blerje materiale pastrimi per banjat publike | 120000 | 97260 |
| | Blerje materiale per riparimin e cadrave | 0 | |
| | Blerje tabela dhe bova sinjalizuese dhe informuese ne plazh per sezonin turistik | 700000 | 621600 |
| | **Shuma : 4** | **10,455,000** | **5,772,350** |
| 5 | **INVESTIME** | | |
| | Blerje beze dhe çadra per plazhet publike me logon e bashkise | | |
| | Blerje materiale për sitemin ujites me pika per borduren tek shetitorja 10 Deshmoret | | |
| | Blerje materiale pedane per uren tek Uckat | | |
| | Blerje Tenda sherbimi | | |
| | Blerje Kjoska sherbimi | | |
| | Ndertim tualeti per punonjesit e N.P.R | | |
| | Riparim Tarracash | | |
| | **Shuma: 5** | **3,315,000** | **1,943,760** |
| | **TOTALI:** | **61,370,000** | **52,728,200** |

## NDERMARRJA E MIREMBAJTJES SE INFRASTRUKTURES DHE PUNEVE PUBLIKE

### 1. SEKTORI I ARSIMIT

Argumentimi i Projekt Buxhetit mbi punimet që planifikohen për tu kryer për vitin 2025 nga ana e Sektorit të Mirëmbajtjes së Infrastrukturës Arsimore. Objektet që do të mirëmbahen janë ndërtesat e shkollave, kopshteve, cerdheve me gjithë elementet e saj. Hapësirat dhe sipërfaqja që rrethojnë këto ndërtesa si oboret e shkollave, kendet sportive, muret rethuse etj qe jane nen juridiksionin e Bashkise Pogradec.

**1.Në zërin "*Blerje karburanti*"** me fond prej 19,000,000 lekë argumentimi nis nga fuqia e instaluar e kaldajave që shërbejnë për të patur një ngrohje sipas kërkesave standarte për ngrohjen në ambientet e ndërtesës ku përfshihen klasat, sallat, korridoret këtu është marrë parasysh sasia e harxhuar gjatë viteve, të dhënat teknike të kaldajave të shkollave, cmimi mesatar dhe kërkesa të

tjera për secilën kaldajë dhe ndërtesa vec e vec, është marrë në konsideratë kohëzgjatja që kërkon periudha e ngohjes së shkollave të poshtë shënuara.
1."Gjergj Pekmezi"
2."Muharem Collaku"
3."Kole Koci"
4."Esat Minarolli"
5."Gjok Shqiptari"
6."Kozma Basho"
7."Koli Gusho"
8. "Servet Agolli"
9. "14 Engjejt"
10."Muredin Bashalli"
11. "Persefoni Treni"

**2.Në zërin "Mirëmbajtje ndërtesash"** me fond prej 24,000,000 lekë është perllogaritur nisur nga problematikat që kanë 76 shkollat e bashkisë, bazuar dhe në kërkesat e vazhdueshme të drejtuesve të institucioneve arsimore si dhe problemet që mund të dalin pas mbarimit të vitit shkollor 2024-2025.
Disa nga problemet që hasen herë pas here janë ndërrimi i cative, hidroizolimet, lyerjet me gëlqere, hidromat, plastiko. Pastrimet e oxhaqeve, dëmtimi i këndeve sportive, dëmtimi i mureve te klasave, dëmtimi i banjove si në dyer, dritare etj. Pas mbarimit të vitit arsimor për mirëmbajtjen e cdo shkolle grupi i punes që do të caktohet për llogaritjen e fondit limit do të kryejë inspektim në cdo shkollë pasi do të evidentojë gjithë problematikat në terren do të hartojë projekt preventivat për cdo shkollë ku do të argumentojë fondin që do të duhet për mirëmbajtjen e këtyre ndërtesave.

**3.Ne zërin blerje e materialeve të pastrimit, hidraulike, hidrosanitare, pllaka, xhama, materiale për kaldajat, për mirëmbajtjen e dyerve si dhe materiale të ndryshme** janë marrë parasysh blerjet gjatë viteve dhe eksperienca e fituar ndër vite si dhe cmimet e tregut.
4.Në zërin **ndërtim mure rrethues** me fond 1,000,000 lekë problematika është e larmishme duke u nisur nga dëmtimet që kryhen në rrethimet me mure dhe kangjella në dyert e jashtme etj.
Më konkretisht është parashikuar ndërtimi i mureve rrethuese të shkollës Muharem Collaku, një pjesë e murit rrethues të shkollës së fshatit Petrushe për vitin 2024.
5.Në zërin **blerje soba për ngrohje** me fond prej 1,800,000 lekë është marrë parasysh ndërrimi periodik i zëvendësimit të sobave të dëmtuara si dhe rritja e cilësisë të këtyre sobave.

Nisur nga kërkesat e vazhdueshme të drejtuesve të institucioneve arsimore në Bashkinë Pogradec, si dhe në kërkesën e Qendrës Arsimore me nr.142 prot date 28.10.2024 ju paraqesim relacion të detajuar për të gjithë zërat që kanë kërkuar.

**6.Kamera Sigurie per institucionet shkollore.**

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

Nga Qendra Arsimore na është përcjellë informacioni nëpërmjet shkresës me nr.144 prot datë 31.10.2024 që janë 16 shkolla kryesore dhe disa shkolla të tjera vartëse të cilat nuk kanë fare kamera sigurie si dhe shkolla Dëshmorët e Pojskës i nevojiten 5 kamera. Nga testimi i tregut rezulton se nevojiten 400,000 lekë me TVSH për blerjen e kamerave.

Gjithashtu disa prej kamerave në disa shkolla kanë nevojë për shërbim mirëmbajtje, kostoja e së cilit sipas cmimeve të tregut është 70,000 leke me TVSH/vit.

**7. Fikse zjarri**, bazuar në shkresën e Qendrës Arsimore nr149 prot date 08.11.2024, të gjitha godinat funksionale në të cilat zhvillohet mësimi në Bashkinë Pogradec përbëhen nga 133 kate. Për secilin kat do të vendosen 2 fikëse zjarri si dhe nga 2 tabela sinjalizuese "Exit". Për rrjedhojë janë kërkuar 266 fikse zjarri, nga të cilat 260 copë fikëse zjarri me pluhur dhe 6 cope fikëse zjarri me shkumë dhe 260 copë tabela sinjalizuese "Exit".

Nga testimi i tregut për këto materiale rezulton se shuma totale e nevojshme për blerjen e materialeve të mësipërme është: 920,000 leke me TVSH.

**8. Shërbim dizinfektimi**, Nisur nga kërkesat e vazhdueshme të drejtuesve të institucioneve shkollore, rekomandimeve të Institutit të Shëndetit Publik si dhe të Qendrës Arsimore me anë të shkresës me nr148 prot date 08.11.2024 është kerkuar kryerja e shërbimeve si më poshtë:

1. Shërbim dezinsektimi

2.Shërbim deratizimi

3.Shërbim dizinfektimi

Sipërfaqja totale ku zhvillohet mësimi në të gjitha IA të Bashkisë Pogradec është 28,522.55 m². Nga testimi i tregut për realizimin e tre shërbimeve të mësipërme në të gjithë sipërfaqen është 5,700,000 leke me TVSH.

| Emertim | Plan 2024 | Pritshmi 2024 |
|---|---|---|
| Blerje karburant per ngrohje. | 19,000,000 | 17,850,000 |
| Mirembajtje Institucioneve shkollore | 24,000,000 | 21,477,849 |
| Material dezifektimi | 300,000 | 186,000 |
| Sherbim dezifektimi | | |
| Materiale Pastrimi | 1,800,000 | 1,229,580 |
| Blerje Fikse zjarri | | |
| Blerje Kamera shkolla | | |

| | | |
|---|---|---|
| Mirembajtje sistem kamerave | | |
| Materiale hidraulike | 900,000 | 731,760 |
| Materiale elektrike | 900,000 | 861160 |
| Materiale hidrosanitare,pllaka | 450,000 | 438,432 |
| Xhama | 300,000 | 216,000 |
| Materiale per kaldajat | 350,000 | 320,000 |
| Materiale per mirembajtjen e dyerve | 350,000 | 304,800 |
| Blerje Materiale te ndryshme | 1,000,000 | 920,000 |
| **Shuma** | **49,350,000** | **44,535,581** |
| Ndertim mure rrethuese shkollat | 1,000,000 | 935,800 |
| Blerje soba per ngrohje | 1,800,000 | 1,754,400 |
| **Investime** | **2,800,000** | **2,690,200** |
| **Totali 05** | **52,150,000** | **47,225,781** |

## 2. Sektori I Mirëmbajtjes Së Infrastrukturës Urbane

**Argumentimi i P/Buxhetit mbi Punimet që planifikohen pë r tu kryer pë r vitin 2025 nga ana e** Sektorit Mirë mbajtes Infrastrukturë s Urbane dhe Godinave.Objektet që do të sistemohen.

1.Rrugicë + sheshe në lagjen 4. kala 520m2(260ml bordure 15x25)

2.Pazari pjesa në krah të djathtë Afë rsisht 1400 m2(bordure të derdhur e kombinuar120ml bordurë 15x25)

3.Rruga Gorica,Bellovoda,Justiniani mbi varezat publike të qytetit dhe blloku i banesave që janë aty 1900m2(e pë rafert) (bordurë të derdhur)

4.Rruga mbi varezat publike të fshatit Vë rdovë Aleksandë r Xhuvani dhe blloku i banesave që janë aty 1536m2(e pë rafë rt) (bordurë të derdhur+)

7. Pë r tu realizuar shtrimi i kë tyre sipë rfaqeve vlen të pë rmendim se shtrimi i kë tyre sipë rfaqeve me pllaka t=6cm, t=8cm do të kryhet nga punonjë sit e kë tij sektori. Prandaj llogaritjet tona konsistojnë vetë m në blerjen e materialeve të ndë rtimit kurse pavë rsisht parashikimit ne do të zbatojmë prioritetet që do të na jepen dhe objektivat që do të na caktohen sipas problematikë s të paraqitur.

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA POGRADEC

8.Riparime mermetime të të trotuareve,rrugë ve, kë ndeve të lodrave pë r femijë , kufizime e pemeve sipas nevojave kë to procese do parashikohen mbeshtetur në eksperiencë n e viteve.

9.Sinjalistika horizontale,vetikale fondi i caktuar do të konsistoj në blerjen bojrave akrelikë pë r vijë zimet periodike dhe në kompletimi i sinjalistikë s vertikale.

10. Mirë mbajtja e varezave publike,fondi i llogaritur pë r shë rbimin e varimit publik konsiston në prodhimi i pllakave pë r varimin publik,si dhe në mirë mbajtjen e sipë rfaqeve të varezave.

11.Mirë mbajtja e godinave që kemi në iventar sipas prioriteteve që do na caktohen.

12.Qellimi:Pë rmiresimi i Infrastrukturë s urbane pë r të pë rmirë suar kushtet e jetesë s të banorë ve që jetojnë në afërsi të këtyre siperfaqeve. Krijimi i kushteve sa më të mira për levizje për clodhje dhe shfrytezimin e hapisarave publike.

13.Përsa i perket caktimit të prioriteve objektet e paraqitura mund të ndryshojnë sipas urdhrave të titullarit brenda fondit të pë rcaktuar në objektet të tjera që shikohen me të arsyeshme pë r tu zgjidhur.

14.Më e poshtë paraqesim materialet që do të pë rdoren nga S.M.I.Urbane dhe Godinave në një tabelë të vetme , kurse pë r cdo pikë që nga pika 1deri në pikë n 6 do të paraqesim projekt preventivat pë rkatë s të cila mund të lë vizin me një marzh gabimi shpresojmë të vogë l. Kurse në zë rat takse+siguracione cmimet pë r mjetet janë fikse me kë rkesë ofertë tregu,në zë rin pjesë kë mbimi mund të themi kjo do të varet nga ecuria e mjetit mund të jenë të mjaftushme ose të pakta të vetmin konkluzion që mund te themi duke parë gjë endjen teknike të mjeteve dhe vjetersinë mbë shtetur në ekspiriencë n e viteve ato kanë qenë të pa mjaftueshme.

| Nr | | Pershkrimm | Njesia | Sasia | cmimi | vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Sektori I M. I.Urbane dhe Godinave** | | | | |
| | | **Sherbimi Varimi Publik** | | | | |
| 1 | | Rere (granil guri) | m3 | 63.64 | 1500 | 95460 |
| 2 | | Cakull I fraksionuar 3/5 | m3 | 102.12 | 1420 | 145010.4 |
| 3 | | Cimento 42.5R | kg | 44400 | 13.80 | 612720 |
| 4 | | Plehma (zgare hekuri kuadrat 10x10cm) | m2 | 2294 | 132 | 302808 |
| 5 | | Hekur ϕ8mm | kg | 1456 | 110 | 160160 |
| 6 | | Tel bari ϕ 0.5mm | kg | 11.08 | 120 | 1329.6 |
| 7 | | Shuma pa TVSH | | | | 1317488 |
| 8 | | T.V.SH 20% | | | | 263497.6 |
| 9 | | Shuma me TVSH | | | | **1.580.985.6** |
| | | | | | | |
| | | **S.M.I. Urbane dhe Godinave** | | | | |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Pllaka per shtrim trotuari 20x10x8cm | m2 | 5380 | 900 | 4842000 |
| 2 | | Pllaka per shtrim trotuari 40x40x3cm | m2 | 150 | 800 | 120000 |
| 3 | | Cakull makinerie I fraksionuar 3/5 | m3 | 300 | 1420 | 42600 |
| 4 | | Cakull makinerie I fraksionuar 10/20 | m3 | 120 | 1420 | 170400 |
| 5 | | Rere nga granili I thyer | m3 | 150 | 1500 | 225000 |
| 6 | | Cimento 32.5R | kg | 30500 | 12 | 36600 |
| 7 | | Gozhde 6,10,cm | kg | 30 | 90 | 2700 |
| 8 | | Hekur betoni ϕ 6mm-12mm | kg | 100 | 110 | 11000 |
| 9 | | Tubo plastike korrogato ϕ160-300mm | ml | 30 | 400 | 12000 |
| 10 | | Gradar gize | kg | 600 | 120 | 72000 |
| 11 | | Profile metalike L,U,T,dopjo T me permasa te # | kg | 50 | 180 | 9000 |
| 12 | | Gur trokoje ϕ 220mm | cope | 20 | 180 | 3600 |
| 13 | | Elektroda saldimi ϕ2.5mm | kg | 30 | 250 | 7500 |
| 14 | | Tubo mbrojtese metalike ϕ 50mm | ml | 20 | 160 | 3200 |
| 15 | | Tombino me tubo betoni ϕ 1000 | ml | 6 | 6900 | 41400 |
| 16 | | Tel bari | kg | 10 | 160 | 1600 |
| 17 | | Shuma pa TVSH | | | | 5600600 |
| 18 | | T.VSH 20% | | | | 1120120 |
| 19 | | Shuma me TVSH | | | | **6.720.720** |

Sektori I Mirembajtjes te infrastructures urbane dhe godinave per realizimin e detyrave te ngarkuara per mirembajtjen e varezave publike te qytetit, per rehabilitimin e rrugeve ,shesheve,ne qytet per riparimin e difekteve qe mund te shkaktohen , per mirembajtjen e rjetit kanalizimeve ne gadishmeri per periudhen janar–dhjetor 2024.(materialet e ndertimit si pllaka t=8cm,bordura 15x25cm i ka kerkuar dhe nga F.SH.ZH. per rrugen Gorica,Bellovoda,Justinani Aleksander Xhuvani dhe disa materiale te tjera si tubo beti ϕ 1000mm per prroin e Caprazit etj )

| .Nr | | Pershkrimm | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | **Sektori I M. I.Urbane dhe Godinave** | | | | |
| 1 | | Nafte per kamioncinen tip Ford me targa AA217GR | litra | 1335 | | |
| 2 | | Nafte per kamioncinen tip Ford me targa AA223GR | litra | 1340 | | |
| 3 | | Nafte per koshin AA109TL | litra | 720 | | |
| 4 | | Nafte per BOBKADIN | litra | 720 | | |
| | | SHUMA | litra | 4115 | 170 | **699.550** |

Grupi i punë s pasi u njoh me problematikat dhe kë rkesat e cdo sektori si dhe në pë rparë sitë që ka, cdo sektor bë ri parashikimin e sasisë të materialeve pë r cdo sektor pë rsa i pë rket cmimeve të cdo materiali u mbë shtet në cmimet e manualit që janë aprovuar nga V.K.M Nr.629 date 15.07.2015 si dhe duke bë rë verifikim në vlerë n e tregut ku pë r disa artikuj ka

testuar duke marë edhe oferta.duke u mbeshtetur në cmimet e INSTAT si dhe në cmimet e organeve tatimore dhe doganore ku u perzgjodh cmimi me i favorshem të cilat po i paraqesim sipas tabelave të më sipërme.

| **Emertim** | **Plan 2024** | **Pritshmi 2024** |
|---|---|---|
| Paga 90 punonjes | 46,200,000 | 45,989,000 |
| Sig.shoqer | 7,715,400 | 7,680,163 |
| **Shuma** | **53,915,400** | **53,669,163** |
| **Ndricim Publik rrugor '05.** | **30,000,000** | **25,000,000** |
| | | |
| Kancelari | 720,000 | 690,000 |
| Shtypshkrime | 30,000 | 30,000 |
| Mat.zyre | 200,000 | 180,000 |
| Sherbim postar | 17,000 | 16,000 |
| **Shpen.adm** | **967,000** | **916,000** |
| **Shpenzime** | | |
| Karburant | 700,000 | 690,000 |
| Taksa+siguracione | 280,000 | 270,000 |
| Pjese kembimi | 1,500,000 | 1,350,000 |
| Shpenzime te tjera transporti+(Kolaudim) | 250,000 | 240,000 |
| **Shuma** | **2,730,000** | **2,550,000** |
| **Blerje** | | |
| Materiale ndertimi | 1,400,000 | 1,260,000 |
| Materiale pune veshmbathje. | 700,000 | 630,000 |
| UJE | 500,000 | 270,000 |
| Shpenzime qera sektori automjeteve | 1,500,000 | 1,481,248 |
| Shpenzime per realizimin e dekorit / | 100,000 | |
| Materiale elektrike | 5,000,000 | 4,778,840 |
| Materiale per sherbimin e varrimit | 1,600,000 | 1,565,669 |
| Sinjalistika horizontale & Vertikale | 2,000,000 | 1,800,744 |
| Blerje materiale te ndryshme | 1,000,000 | 910,000 |
| Shpenzime lidhje energjie | 850,000 | 370,000 |
| Sherbim projekt elektrik | 100,000 | 265,000 |
| **Shuma** | **14,750,000** | **13,331,501** |
| Blerje Printer PMF | 200,000 | |
| Mjete-pune. | 500,000 | |
| Vinc me Kosh | 3,000,000 | 2,988,000 |
| Paisje per oficinen. | 150,000 | |

| | | |
|---|---|---|
| Blerje Fv Piston bllokues trafiku | | |
| **Shuma Investime** | 3,650,000 | 2,988,000 |
| **Totali '05** | 106,212,400 | 98,454,664 |

## 3. Sektorin e Ujitje Kullimit.

Më poshtë po ju paraqesim shpenzimet e planifikuara për Sektorin e Ujitje kullimit:

**Objekti** : F.V tubo betoni fusha Çërravë ,Buçimas,Udënisht VITI 2025

| NR | NR.an | EMËRTIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 2.554 | F.V tubo betoni ф 400 mm Fe ф 8 mm | ml | 14 | 2,098.00 | 29,372.00 |
| 2 | 2.556 | F.V tubo betoni ф 600 mm me hekur Fe ф 8 mm | ml | 14 | 4,057.00 | 56,798.00 |
| 3 | 2.557 | F.V tubo betoni ф 800 mm me hekur Fe ф 8 mm | ml | 12 | 8,176.00 | 98,112.00 |
| 4 | 2.558 | F.V tubo betoni ф 1000 mm me hekur Fe ф 8 mm | ml | 14 | 10,535.00 | 147,490.00 |
| | | **Shuma** | | | | **331,772.00** |
| | | **T.V.SH 20 %** | | | | **66,354.40** |
| | | **TOTALI** | | | | **398,126.40** |

**Objekti** : Blerje tubo te brinjezuar (korroget)

| NR | NR.an | EMËRTIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 207 | Tubo te brinjezuar ф 200 mm | ml | 228 | 600.00 | 136,800.00 |

| | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 2 | 232 | Tubo te brinjezuar ф 315 mm (6ml/cope) 5 cope | ml | 30 | 1,100.00 | 33,000.00 |
| 3 | 232 | Tubo te brinjezuar ф 315 mm (12ml/cope) 2 cope | ml | 24 | 1,100.00 | 26,400.00 |
| 4 | 234 | Tubo te brinjezuar ф 400mm (6 ml/cope) 2 cope | ml | 12 | 1,750.00 | 21,000.00 |
| 5 | 234 | Tubo te brinjezuar ф 400mm (12ml/cope) 2 cope | ml | 24 | 1,750.00 | 42,000.00 |
| 6 | 238 | Tubo te brinjezuar ф 600 mm | ml | 6 | 12,000.00 | 72,000.00 |
| 7 | 233 | Rakorderi HDPE d=315 mm | cope | 2 | 850.00 | 1,700.00 |
| | | **Shuma** | | | | **332,900.00** |
| | | **T.V.SH 20 %** | | | | **66,580.00** |
| | | **TOTALI** | | | | **399,480.00** |

Objekti : Blerje pjese kembimi ( VOLVO EC 220 DL )

| NR | NR I analizes | Emertimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera ( leke ) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Filter nafte | cope | 5 | 3700 | 18,500 |
| 2 | | Filter vaji | cope | 5 | 1700 | 8,500 |
| 3 | | Filter ajri | cope | 5 | 6500 | 32,500 |
| 4 | | Parafilter nafte | cope | 5 | 5500 | 27,500 |
| 5 | | Filter hidraulik 16019 | cope | 3 | 2000 | 6,000 |
| 6 | | Filter hidraulik FSO 913 / 1H | cope | 3 | 5200 | 15,600 |
| 7 | | Filter ajri kondicionuar | cope | 1 | 7000 | 7,000 |
| 8 | | Zinxhire pa pllaka 49 Hallka | cope | 2 | 180000 | 360,000 |
| 9 | | Bullona +dado zinxhiri | cope | 392 | 205 | 80,360 |
| 10 | | Rrote e dhembezuar | cope | 2 | 26500 | 53,000 |
| 11 | | Rrote drejtuese | cope | 2 | 78500 | 157,000 |
| | | **SHUMA** | | | | **765,960** |
| | | **TVSH 20 %** | | | | **153,192** |
| | | **TOTAL** | | | | **919,152** |

CATEPILLAR BACKHOE LOADER CFG1 MODEL 428-07A

| NR | NR I analizes | Emertimi | Njesia | Sasia | Cmimi | Vlera ( leke ) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Filter nafte | cope | 5 | 3500 | 17,500 |
| 2 | | Filter vaji | cope | 5 | 1550 | 7,750 |
| 3 | | Filter ajri | cope | 5 | 6300 | 31,500 |
| 4 | | Parafilter nafte | cope | 5 | 5500 | 27,500 |
| 5 | | Filter hidraulik 16019 | cope | 3 | 2000 | 6,000 |
| 6 | | Filter hidraulik FSO 913 / 1H | cope | 3 | 5200 | 15,600 |
| | | **SHUMA** | | | | **105,850** |
| | | **TVSH 20 %** | | | | **21,170** |
| | | **TOTAL** | | | | **127,020** |

**Objekti** : Blerje Vaj makine (VOLVO EC 220 DL)

| NR | NR.an | EMËRTIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Vaj motorri 15 - 40 | litra | 128 | 440.00 | 56,320.00 |
| 2 | | Vaj hidraulik 46 | litra | 245 | 300.00 | 73,500.00 |
| 3 | | Vaj per reduktoret plus rrotulluesi 90 | litra | 134 | 325.00 | 43,550.00 |
| 4 | | Graso jeshile | kg | 135 | 450.00 | 60,750.00 |
| | | Antifrize | litra | 33 | 280.00 | 9,240.00 |
| | | **Shuma** | | | | **243,360.00** |
| | | **T.V.SH 20 %** | | | | **48,672.00** |
| | | **TOTALI** | | | | **292,032.00** |

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

CATEPILLAR BACKHOE LOADER
CFG1 MODEL 428-07A

| NR | NR.an | EMËRTIMI | Njësia | Sasia | Çmimi | Vlera (lekë) |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Vaj motorri 10 - 30ë | litra | 80 | 350.00 | 28,000.00 |
| 2 | | Vaj hidraulik 30 | litra | 150 | 300.00 | 45,000.00 |
| 3 | | Vaj per reduktoret plus rrotulluesi 90 | litra | 100 | 325.00 | 32,500.00 |
| 4 | | **Shuma** | | | | **105,500.00** |
| | | **T.V.SH 20 %** | | | | **21,100.00** |
| | | **TOTALI** | | | | **126,600.00** |

**I.Karburant** 3'200'000 lekë

Në vit 220 ditë pune x 3.5 orë punë / ditë = 770 orë pune

Nafte 11'550 litra gjithsej

Eskavator VOLVO EC 220 DL 11'550 litra

Pastrim kanale kullues 500 ore x 149.6 $m^3$/ore = 74'800 $m^3$ dhera

Pastrim kanale ujitës

Pastrim Rezervuar të vegjël ore 500 x 14.9 litra / ore = 7'450 litra nafte

Pastrim Përrenj - lumenj

- Hapje rruge per parcela ore 200 x 14.9 litra / ore = 2980 litra nafte
- Hapje prita , ngritje port barazhe ore 70 x 14.9 litra / ore = 1043 litra nafte
- Pastrime te ndryshme ne sistemet kulluese – ujitese ( ura ne kanale kullues , puseta dalese, hyrese ne rezervuar etj )

CATEPILLAR BACKHOE LOADER CFG1 MODEL 428-07A

Në vit 220 ditë pune x 3orë punë / ditë = 660 orë pune

Nafte 3'960 litra gjithsej

| Emertim | Plan 2024 | Pritshmi 2024 |
|---|---|---|
| Paga administrata 8 punonjes. | 3240000 | 2621000 |

| | | |
|---|---|---|
| Sig.shoqer | 501000 | 437707 |
| **Shuma** | **3741000** | **3058707** |
| Kancelari | 25,000 | 25000 |
| Shtypshkrime | 15,000 | 15,000 |
| Mat.zyre | 12,000 | 12,000 |
| Udhetime, dieta | 25,000 | 0 |
| **Shpen.adm** | **77,000** | **52000** |
| Karburant | 3,000,000 | 2870000 |
| Vaj makine | 300,000 | 260000 |
| Pjesë këmbimi | 350,000 | 340000 |
| **Shpenz.op** | **3,650,000** | **3470000** |
| Mirembatje Kanale Ujitese-kulluese. | 3,094,000 | 2800000 |
| Blerje Tubo te brinjezuar | 600,000 | 540000 |
| Furnizim Vendosje tubo betoni | 400,000 | 398000 |
| Fond rezerve | 500,000 | 0 |
| **Shuma Mirembajtje Inf.Ujitëse** | **4,594,000** | **3738000** |
| **TOTALI** | **12,062,000** | **10318707** |

## 4. SEKTORI I RRUGËVE RURALE

Argumentimi i P/Buxhetit mbi Punimet qe planifikohen per tu kryer per vitin 2025 nga ana e Sektori i M.Rr.Rurale.Objektet qe do te sistemohen.

1.Fshati Verdove Izaja Molla Sip=3220m2 (e perafert) (bordure+ bordure te derdhur) kjo siperfaqe lidh rrugen Aleksander Xhuvani me fshatin Verdove takohet ne 2vende me rrugen kryesore te ketij fshati procesi I punes do te jete SIstemim i ujrave shtrim me pllaka t=8cm Pllaka+cakull 3/5mm,10/20mm rere, cimento, bordure

Sistemim i ujrave shtrim me pllaka t=8cm Pllaka+cakull 3/5mm,10/20 mm rere, cimento, bordure.

2.Rrugicat qe jane ne te dy krahe e Rruges Tushemishtit .Nehemia etj 2. Sip=5250m2(e perafert) (bordure te derdhur) ketu jane disa rugica qe quhen me te njejtin emer te cilen ndodhen ne krah te rruges te volorekes procesi I punes do te jete SIstemim i ujrave shtrim me pllaka t=8cm Pllaka+cakull 3/5mm,10/20mm rere, cimento, bordure.

3.Qellimi:Permiresimi i Infrastruktures RURALE per te permiresuar kushtet e jeteses te banoreve qe jetojne ne afersi te ketyre siperfaqeve.krijimi I kushteve sa me te mira per levizje per clodhje dhe shfrytezimin e hapisarave publike.

4.Per sa I perket caktimit te prioriteve objektet e paraqitura mund te ndryshoojne sipas urdhrave te titullarit brenda fondit te percaktuar ne objektet te tjera qe shikohen me te arsyeshme per tu zgjidhur.

5.Me poshte paraqesim materialet qe do te perdoren nga Sektori i M.Rr.RURALE ne nje tabele te vetme.Per piken 1, piken 2 do te paraqesim projekt preventivat perkates te cila mund te levizin me nje marzh gabimi shpresojme te vogel. Kurse ne zerat takse+siguracione cmimet per mjetet jane fikse me kerkese oferte tregu,ne zerin pjese kembimi mund te themi kjo do te varet nga ecuria e mjeteve mund te jene te mjaftushme ose te pakta te vetmin konkluzion qe mund te themi duke pare gjendjen teknike te mjeteve dhe vjetersine mbeshtetur ne ekspieriencen e viteve ato kane qene te pa mjaftueshme.

| Nr | | Pershkrim | Njesia | Sasia | cmimi | vlera |
|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | Rere (granil guri) | m3 | 120 | 1500 | 180000 |
| 2 | | Cakull I fraksionuar 3/5 | m3 | 600 | 1420 | 852000 |
| 3 | | Hekur ϕ8mm | kg | 100 | 110 | 11000 |
| 4 | | Tel bari ϕ 0.5mm | kg | 40 | 120 | 4800 |
| 5 | | Gozhde 6,10,cm | kg | 50 | 90 | 4500 |
| 6 | | Hekur betoni ϕ 6mm-12mm | kg | 300 | 110 | 33000 |
| 7 | | Cimento 32.5R | kg | 40000 | 13 | 520000 |
| 8 | | Cakull I fraksionuar 10/20 | m3 | 92 | 1420 | 130640 |
| 9 | | Lende druri | m3 | 4 | 18000 | 72000 |
| 10 | | Gozhde 6,8,10cm | kg | 50 | 100 | 5000 |
| 11 | | Gabiona 2mx1mx1m | cope | 10 | 4466 | 44660 |
| 12 | | Tubo betony ϕ 200mm | ml | 20 | 460 | 9200 |
| 13 | | Tubo betony ϕ 300mm | ml | 20 | 750 | 15000 |
| 14 | | Tubo betony ϕ 400mm | ml | 50 | 1100 | 55000 |
| 15 | | Tubo betony ϕ 600mm | ml | 10 | 1750 | 17500 |
| 16 | | Tubo betony ϕ 800mm | ml | 12 | 4800 | 57600 |
| 17 | | Tubo betony ϕ 1000mm | ml | 24 | 6900 | 165600 |
| 18 | | Cakull me mbeturina per mbushje | m3 | 250 | 300 | 75000 |
| 19 | | Pllaka t=8cm | m2 | 9800 | 900 | 8820000 |
| 20 | | Gur kave | m3 | 40 | 920 | 36800 |
| | | Shuma pa TVSH | | | | 11109300 |
| | | T.V.SH 20% | | | | 2221860 |

| | | Shuma me TVSH | | | | 13.331.160 |
|---|---|---|---|---|---|---|

Sektori i M.Rr.RURALE materialet per rruge nehemia i ka kerkuar dhe nga F.SH.ZH.

6.Karburanti eshte llogaritur ne baze te perllogaritjes per secilin mjet , eshte marre parasysh puna qe do te kryej, harxhimi ne tre vitet e mepareshme ,cmimi per njesi eshte bazuar ne cmimin e vitit 2023 . Ore pune makinerie1. J.S.B.Tereks AFMT-07 820 o/pune sasia e naftes 9020 litra 2. Traktori DT 75 K/F 200o/pune sasia e naftes 2400 litra. 3.Ruli200o/pune siasa e naftes 2000 litra 4.kamioni AA517 PT km te llogaritura 28000 sasi e naftes 11200 litra 5. kamioni PG4096B km te llogaritura 20000 sasi e naftes 6000 litra 6. kamioncina AA258UF km te llogaritura 18000 sasi e naftes 2340 litra 7. Kamioncina AA189YP km te llogaritura 18000 sasi e naftes 2340 litra.8.Kamioni benz vinc km llogaritura 18000 sasi e naftes 7740 litra. per mjetet e tjera qe do te blihen 9600 litra. Shuma e pergjitheshme me T.V.SH. 52640 litra x 190lek=

7.Pjese kembimi per mjetet me gjithe T.V.SH 2000000

8.Makineri: a)minieskavator 1800000. b)kamioncine vete shkarkuse me gjashte vende 1500000

Rendesia per blerjen e mjeteve eshte sipas renditjes

9.Rezerve dimerore a)Kripe reserve dimerore 14500kg x 16lek= 232000lek b)granil nga guri i thyer 12m3x1500=18000 Shuma .pa T.V.SH. 250000lek. T.V.SH.20% SHUMA .300000

10. Persa i perket zerave te taksave,siguracioneve,transporti+kualidim ato jane tarifa shtetrore per secilin mjet,kurse ne vajrat gomat pjeset ndrimit perfshihen ndrimet periodike te ketyre mjeteve me vajra filtra etj si dhe demtimet qe mund te pesojne mjetet ose difektet te paparishikuara.

11.Shenim:Materialet do te perdoren sipas preventivave te hartuar.
1) cakulli do te perdoret per karikimin e rrugeve sipas kerkesave te Njesive Administrative disa akse me te demtuara jane a)Kalivac-Dunice 3.km b)Dardhas –Osnat 6km. c)Pleshisht-Selce e Siperme 3km.d)Buzeahishte-Senisht 3km. Kurse materialet e ndertimit do te perdoren n.q.s do te kemi shembje pas periudhes dimerore dhe eshte llogaritur ne baze te ekspirences te grumbulluar ne keto vite.
2) Tombinot me tubo betoni do te vendosen neper rruget kumonale te fshatrave,ne rruget hyrese te parcelave ,ne vendet ku mund te jene te demtuara konkretisht : Dardhas,Stropcke,Prenisht,Osnat,Cerrave,Bletas,Alarup,Lumas,Pleshisht,Trebinje,Dunice, Kalivavc,Hoshtec,CezmeMadhe,Pole,Buqeze,Memlisht,Udenisht,Proptish,Homcan,Homezh, Rodokal I Siperm, Rodokal I Poshtem,Slatine,Slabinje,Velcan,Bishnice, Laktesh,Slabinje. Bucimas, Verdove,Remenje,Geshtenjas.

| Emertim | Plan 2024 | Pritshmi 2024 |
|---|---|---|
| Paga administrata 50 punonjes | 29,100,000 | 24,800,000 |
| Sig shoqer | 4,859,700 | 4,141,600 |
| **Shuma 01** | **33,959,700** | **28,941,600** |
| Karburant | 10,001,600 | 9,890,530 |
| Vajra filtra | 1,200,000 | 840,000 |
| Siguracione Mjetesh | 390,000 | 310,468 |
| Blerije material ndertimi | 13,370,955 | 10,169,343 |
| Taksa+siguracione | 180,000 | 160,000 |
| Shpenzime te tjera transporti+kolaudimi | 56,445 | 55,000 |
| **Shuma 01** | **25,199,000** | **21,425,341** |
| Blerje kripe dhe granil | 300,000 | 270,000 |
| Blerje materiale te ndryshme | 1,000,000 | 900,000 |
| Goma | 1,200,000 | 750,120 |
| Pjese nderimi | 1,300,000 | 1,233,750 |
| **Shuma 05** | **3,800,000** | **3,153,870** |
| **Makineri/ Investime** | | |
| Asfaltimi I rrjetit rrugor ne njesite adm Pogradec | 54,047,740 | 54,047,740 |
| Minieskavator. | 1,800,000 | |
| **Shuma** | **55,847,740** | **54,047,740** |
| **TOTALI '01+'05** | **118,806,440.00** | **107,568,551.00** |

**NDERMARRJA E MBROJTES SE TERITORRIT**

NMT do të jete një ndërmarrje e cila në përbërje të saj do të ketë:

- Policinë Bashkiake
- Inspektoriatin e ndërtimit
- Sektorin e mbrojtjes së konsumatorit
- Sektorin e administrimit të pyjeve

Krijimi i Ndërmarrjes del si nevojë e mirëfuksionimit të inspektoriateve në bashkinë Pogradec. Grumbullimi i inspektoriateve në një drejtori bën që puna të jetë më e evidentueshme dhe e matshme. Gjithashtu dhe kontrolli do të jetë akoma më i madh. Me ligjet e reja për sektorin pyjor dhe të inspektoriateve doli si nevojë krijimi i ndërmarrjes së re.

Shpezimet për këtë ndërmarrje konsistojnë në:

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA POGRADEC

1. Paga dhe sigurimet janë përllogaritur për rreth 70 punonjës në shumën 9,998,000 lekë
2. Shpenzimet administrative janë shpenzime për mirëfunksionimin e ndërmarrjes. Këto shpenzime janë të shkëputura nga buxheti i bashkisë duke qënë se këta sektorë kanë qënë pjesë e Bashkisë. Këto zëra janë në shumën 7,650,000 lekë.
3. Shpenzimet për sektorin e Administrimit të pyjeve janë shpenzime të cilat sigurohen nga grandi i qeverisë.

## MBI NUMRIN E PËRGJITHSHËM TË PUNONJËSVE NË BASHKINË POGRADEC DHE NDËRMARRJEVE NË VARËSI TË SAJ

Në zbatim të Vendimit nr. 893, datë 17.12.2014 "Për miratimin e regullave të organizimit dhe të funksionimit të kabineteve ndihmëse, të organizimit të brendshëm të institucioneve të administratës shtetërore, si dhe për procedurat e hollësishme për përgatitjen, propozimin, konsultimin dhe miratimin e organizimit të brendshëm", **për vitin 2025** është menduar një strukturë e cila të mbulojë funksione politikëbërëse, funksione rregullatore dhe të ofrimit të shërbimeve, duke respektuar nivelet e ndryshme të hierarkisë. Në këtë qëllim numri i përgjithshëm i punonjësve të bashkisë qëndër, njësive administrative si dhe ndërmarrjeve në varësi për vitin **2025 propozohet të jetë 795 punonjës** dhe alokimi si më poshtë:

| | |
|---|---|
| **1.** Bashkia Qëndër, Njësitë Adminstrative dhe MZSH | **248 punonjës** |
| **2.** Qëndra Arsimore | **257 punonjës** |
| **3.** Ndërmarrja e Mirëmbajtjes së Infrastrukturave dhe Punëve Publike | **140 punonjës** |
| **4.** Ndërmarrja e Parqeve dhe Rekreacionit | **75 punonjës** |
| **5.** Ndermarrja e Mbrojtjes se Teritorrit | **75 punonjes** |

Numri i punonjësve me kontratë shërbimi të përkohshme në Bashkinë Pogradec për vitin **2025** është menduar të mbetet i pandryshuar, **20 (njëzet), mbi numrin e përgjithshëm (795 punonjës).**

*Ju Faleminderit!*

Konceptoi: Irsa Karapanca

Anxhela Pilinçi

Enton Berberi

Arben Bektasha

Laura Elmasllari

Miratoi: Dritan Babasuli

**KRYETAR**

**ILIR XHAKOLLI**